

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7561 E shtunë 16 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Zhvillimet në marrëdhëniet
Zndërkombëtare janë të vrullshme dhe me ngjarje shumë të rëndësishme, që pasurojnë me shpejtësi përmbajtjen ...
Vijon në faqen 21

Nga VASIL KURETA

Si mund të lexohet kjo G7?



Opinion *i* Ditës

Dekada të shkuara, të huajt
pëlqenin të tregonin një gjëgjëze mes tyre, teksa vërdalliseshin kryeqytetit të ri të shqiptarëve, që po merrte trajtë ...
Vijon në faqen 22

Nga BEN ANDONI

Gjëgjëza me Shqipërinë dhe kënaqësia për mos hapjen e negociatave!



“Xhuljeta më tha: E dua djalin tënd”

Vrasja e dyfishtë të "Don Bosko", i ati i djalit: Pres pajtim me familjen e vajzës

“Xhaferri bëri denoncim, por edhe vajza e denoncoi. Ngjarja mund ta parandalohej”

KLODIANA LALA

Një makinë policie qëndron e stacionuar 24 orë përpara derës së Taip Matës. Sapo kapërcen portën e hekurit të shtëpisë dykatëshe, kupton se dhimbja dhe tensioni janë përzier bashkë. Vëllai i Xhaferit Matës, djalit ...
Në faqen 7

ATP PUBLIKON LISTEN E PERFITUESVE QË DUHET TË PLOTESOJNË DOSJET

1.100 PRONARET QË MARRIN KOMPENSIM, EMRAT E RINJ

6 muaj afat për dokumentet që mungojnë. Fondi i kompensimit 1.7 miliardë lekë, kush janë aplikantët e viteve 1999-2000 që kanë marrë vendimin e njohjes



(Në foto) Toka (foto ilustruese)

VIZITA NE GJERMANI

Meta me kreun e Bundestagut: Hapja e negociatave, pozitive për rajonin

Në faqen 2

INTERVISTA

Rama: Gati t'i kthejmë shqiptarët që banojnë ilegalisht në Europë

Në faqen 4

"BLUETOOTH"

Turjan Hysko: Nis kapitull të ri në televizion, pse vendosa të ndryshoj

Suplement

FLET EKSPERTJA

Studimet në Itali, dokumentacioni që duhet paraqitur në fazën e parë

Në faqen 8

Aktorët ironizojnë Laert Vasilin që mbështeti prishjen e godinës. Bujar Asqeriu: Më prenë fjalën

Artistët ruajnë Teatrin me turne, Trebicka: Vdesim këtu

Roza Anagnosti: Mëkat i madh të shembet, mbështes protestën. Këtu është jeta jonë

Nga FATMIRA NIKOLLI

Revolucioni nisi me shi. Dhjetëra qytetarë iu bashkuan dhe protestës së artistëve për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, godinës dhe truallit pas kërkesës, projektit dhe projektligjit për ndërtimin e një teatri



të ri përmes partneritetit publik-privat. Artistët e quajtën të dështuar dëgjuesën me kreun e bashkisë Erion Veliaj. Ata thanë që prej ditës së djeshme nis ruajtja me turne. Dje protestës iu bashkua edhe Roza Anganosti e Sesi-lia Plasari.

Në faqen 20

INTEGRIMI PRESIDENTI

Presidenti, i ftuar nderi në Takimin e 23-të Ndërkombëtar të Berlinit

Meta me kreun e Bundestagut: Çelja e negociatave, sinjal pozitiv në rajon

"Jemi të vetëdijshëm për punët e mëdha që duhet të bëjmë"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u prit dje, nga Presidenti i Bundestagut të Gjermanisë, Dr. Wolfgang Schäuble. Presidenti Meta shprehu mirënjohjen e thellë për ndihmën dhe mbështetjen e gjithanshme që Gjermania i ka dhënë Shqipërisë dhe shqiptarëve, 30 vite bashkëpunim diplomatik dypalësh. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta vlerësoi rolin dhe angazhimin e Gjermanisë në drejtim të integritit të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian. Duke u referuar progresit të bërë në përmirësimin e prioritetëve kyçe, Presidenti Meta theksoi rëndësinë e jashtëzakonshme që do të kishte një vendim pozitiv i Bundestagut gjerman në favor të çeljes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë. "Çelja e negociatave vetëm do të na ndihmonte më shumë për të adresuar më mirë të gjitha prioritetet dhe përmirësimin e standardeve dhe kriteret e nevojshme, si dhe do të jepte një sinjal shumë pozitiv për të gjitha forcat në rajon", - nënvizoi Presidenti Meta. Gjatë takimit u vlerësua premtues dhe inkurajuese marrëveshja mes qeverisë greke dhe asaj maqedonase për zgjidhjen e çështjes së emrit të Maqedonisë dhe u theksua rëndësia e përfundimit të fazës finale të dialogut Kosovë-Serbi. Të dy bashkëbiseduesit ndanë shqetësimin për çështjet e sigurisë që kërcënojnë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe theksuan nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë në këtë drejtim, si në nivel dypalësh ashtu edhe në atë rajonal e europian. Po dje, Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë si i ftuar nderi i Bunde-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me Presidentin e Bundestagut të Gjermanisë, Dr. Wolfgang Schäuble.

Deklarata

"Çelja e negociatave do të ishte një shtysë inkurajuese për adresimin edhe më të fortë të prioritetëve kyçe", - theksoi dje, Presidenti Meta, i cili u shpreh se shqiptarët janë të vetëdijshëm për punën e madhe që i pret në vijim.

stagnet gjerman në Takimin e 23-të Ndërkombëtar të Berlinit. Gjatë fjalës në këtë aktivitet, Kreu i Shtetit theksoi se, sot paqja dhe stabiliteti janë të pranishme në rajonin tonë dhe kemi mundësinë historike për ta bërë atë të pakthyeshme. Në këtë frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të ndërsjellë, vijoi më tej Meta, në lutëm bashkërisht

që çështja e emrit të Maqedonisë të zgjidhet sa më parë dhe falënderojmë Zotin për progresin historik të ditëve të fundit dhe finalizimin e saj. Po kështu u lutëm që dialogu ndërmyjet Kosovës dhe Serbisë të përparojë drejt një zgjidhjeje përfundimtare të pranueshme për të dyja vendet, - nënvizoi Presidenti. Duke u referuar temës së

takimit, Presidenti Meta nënvizoi, gjithashtu, se pavarësisht izolimit të gjatë komunist, uria e shqiptarëve për dashurinë dhe përkushtimin ndaj Zotit ishte tejet e madhe. "Përpjekje satanike u bënë gjatë regjimit diktatorial për të reduktuar interesin e shqiptarëve vetëm tek "buka e përditshme" dhe zbratur shpirtin e tyre nga besimi dhe dashuria në Zot. Nuk do të gjeja shprehje më të bukur se ajo e Nënë Terezës që thotë se: Uria për dashurinë është më e vështirë të largohet se sa uria për bukë", - u shpreh Meta. Presidenti Meta nënvizoi, gjithashtu, edhe progresin e bërë nga Shqipëria nën drejtim të procesit të integritit evropian dhe theksoi se, vetëm dy javë na ndajnë nga vendimi i rëndësishëm që pritet të merret nga Këshilli Europian për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. "Ne lutemi që ky vendim të jetë pozitiv si për ne, ashtu edhe për fqinjën tonë Maqedoninë. Brenda kësaj lutejme qëndron dhe vetëdija e plotë për punën akoma më të madhe që duhet të bëjmë për të rritur cilësinë dhe standardet në të gjitha fushat e politikës. Çelja e negociatave do të ishte një shtysë inkurajuese për adresimin edhe më të fortë të prioritetëve kyçe", - theksoi Presidenti Meta.

Shqipëria me përfaqësues në Komitetin e të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara

Gentian Zyberi nga Shqipëria u zgjodh anëtar i Komitetit të të Drejtave të Njeriut për periudhën 2019-2022 gjatë Takimit të 36-të të Shteteve palë Konventës për të Drejtat Politike dhe Civile, që u zhvillua në Nju Jork. Gentian Zyberi është i pari ekspert i të drejtave të njeriut nga



vendi ynë që anëtarësohet në këtë Komitet, që nga hyrja në fuqi e Konventës

për të Drejtat Politike dhe Civile për Shqipërinë në vitin 1992. Rritja e përfaqësimit të vendit në organet e të drejtave të njeriut të OKB është një angazhim konstant i diplomacisë shqiptare dhe kontribut i drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta në Takimin e 23-të Ndërkombëtar të Berlinit.

Pritet përgjigjia e dy letërporosive

Hetimi për lobimin rus, prokuroria sekuestron regjistrat tatimorë të PD

Në një kohë që prokuroria e Tiranës pret përgjigjen e dy letërporosive të dërguara në SHBA dhe Skoci, akuzat sekuestrore regjistrat tatimorë dhe ato të degës së thesarit mbi dosjen e lobimit rus në favor të Partisë Demokratike. Burime pranë Prokurorisë së Tiranës thanë për Vizion Plus se veprimi procedural bëhet për të krahasuar pasqyrat financiare të sekuestruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me deklaratimet zyrtare në organet tatimore për pagesat e dorëzuara nga Partia Demokratike. Për këtë prokuroria nisi dhe hetimin me akuzën e falsifikimit të formulave pas dyshimeve se Partia Demokratike ka dorëzuar në KQZ të dhëna të rreme për financimin. Lidhur me dosjen, hetimi i së cilës nisi në nëntor të vitit 2017 akuzat shqiptare dërgoi dhe dy letërporosi në Shtetet e Bashkuara dhe Skoci, ku kërkohet informacione se si lobuesi i Partisë Demokratike Nikolas Muzin u pagua për të vendosur kontakte në Uashington. Për të njëjtin hetim në pyetje u mor edhe Sekretari i Përgjithshëm, Arben Ristani, i cili përsëriti se Partia Demokratike nuk ka asgjë për të fshehur dhe se akuzat janë thjesht një tymnajë. Selia blu pretendon se i ka paguar ko-



DOSJA

Lidhur me dosjen, hetimi i së cilës nisi në nëntor të vitit 2017 akuzat shqiptare dërgoi dhe dy letërporosi në Shtetet e Bashkuara dhe Skoci, ku kërkohet informacione se si lobuesi i Partisë Demokratike Nikolas Muzin u pagua për të vendosur kontakte në Uashington.

mpanisë "Biniatta Trade" të Muzin, 150 mijë dollarë për lobim. Por sipas kompanisë së Nikolas Muzin, rezultoni se ka marrë tri pagesa në një shumë prej 675 mijë dollarësh për punën në favor të Partisë Demokratike në vitin 2017.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociales: Rezarta Delsula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevla SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Llaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës së Autokatorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123, Tiranë, Internet: www.gsh.al, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



AKUZA

PD-ja akuzoi kryeministrin Rama se në mënyrë flagrante dhe korruptive vendosi një kompani fantazmë me 100 mijë lekë kapital për të operuar me linjën ajrore "Air Albania". Deputeti Strazimirin tha se Rama ia ka dhënë mikut të tij vlonjat Sinan Idrizi. PD pretendon se 9 ditë përpara daljes së vendimit të posaçëm të qeverisë ka krijuar kompaninë fantazmë.

Ideja për refugjatë nga Lindja e Mesme dhe Afrika

Kamp emigrantësh në Shqipëri? Hahn: Ballkani, jo parking refugjatësh

P prej ditësh po qarkullon në mediat e huaja dhe ato vendëse lajmi për mundësinë e ngritjes së një kampi me refugjatë nga Lindja e Mesme dhe Afrika, në Shqipëri ose në Kosovë. Kjo çështje ka sjellë reagimin e ashpër të opozitës. Lidhur me idenë që ka lindur nga Austria dhe Danimarka, reagoi dje edhe Komisioneri për Zgjerimin në BE-së, Johannes Hahn. Ai deklaroi se ky plan nuk mund të realizohet në Ballkan. Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn kundërshtoi hapur idenë për ndërtimin e një kampi refugjatësh në Ballkan për emigrantët nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. "Unë paralajmërova që në



PARALAJMËRIMI

Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn kundërshtoi hapur idenë për ndërtimin e një kampi refugjatësh në Ballkan për emigrantët nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. "Unë paralajmërova që në valën e parë në vitin 2015 që vendet në rajon, të cilat nuk janë anëtare të BE nuk mund të bëhen parking për refugjatët", deklaroi Hahn.

valën e parë në vitin 2015 që vendet në rajon, të cilat nuk janë anëtare të BE nuk mund të bëhen parking për

refugjatët", deklaroi Hahn. Kryeministri danez, Lars Lokke Rasmussen njoftoi në 5 maj se qeveria e tij ish-

te në bisedime me Austrinë, e cila do të marrë presidencën e radhës së Bashkimit Evropian, si dhe me vende të tjera, "Për një regjim të ri të azilit në Evropë". Plani është për ngritjen e qendrave të pritjes dhe të dëbimit të emigrantëve që do të ngrihen jo në vendet e BE, por në vendet që janë në kufi me të. Lars Lokke Rasmussen nuk i përmendi vendet ku do të ngrihen këto kampe, por gazeta "Le Monde" shkruante pak javë më parë se shumë burime konfirmojnë se bëhet fjalë për dy shtete që synojnë të aderojnë në BE, si Shqipëria dhe Kosova. Por në Shqipëri, qeveria e ka mohuar një gjë të tillë kategorikisht.

Ministri i Jashtëm gjerman: Pasoja fatale, nëse Ballkani lihet jashtë BE-së

Gjermania, Mass: Negociata me kusht për Shqipërinë, bëri progres

"Nëse ndalojmë zgjerimin, dëmtojmë reformat"

Valentina Madani

Gjermania përmes ministrit të Jashtëm jep sinjale pozitive për Shqipërinë, që më 30 qershor të vendosë për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian për integrim. Ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Mass, tek sa komenton çështjet e zgjerimit të Bashkimit Evropian në një editorial në "Atlantic Council", paralajmëron se nëse vendet e Ballkanit Perëndimor nuk integrohen në BE, atëherë do të ketë pasoja fatale. Ministri gjerman foli për progresin që ka bërë Shqipëria në rrugën e saj për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Sipas Mass, vendi ynë është duke shënuar hapa progresi në çështjen e reformës në drejtësi. Ai shprehet se është pro hapjes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Sipas tij, nëse Ballkani lihet jashtë BE-së, do ketë pasoja fatale, ndërsa është pro hapjes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, por me disa kushte. "Natyrisht, pranimi në BE është



të i kushtëzuar dhe vendet aspirante duhet që të përmbushin kriteret të përcaktuara qartë. Kjo nuk është vënë kurrë në dyshim. Fokusi është në demokracinë liberale dhe në një shtet funksional të bazuar në sundimin e ligjit. Disa vende kanë bërë përparim të mirë në këto fusha. Një shembull është ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, e cila në të ardhmen do të quhet Republika e Maqedonisë Veriore. Shqipëria ka bërë gjithashtu përparim të dukshëm, duke kryer reforma ambicioze në drejtësi. Kjo është arsyeja pse unë shprehimisht mbështes hapjen e

kushtëzuar të bisedimeve të pranimit me këto dy vende", deklaroi z. Heiko Mass, ministër i Jashtëm i Gjermanisë. Deklarata e ministrit të Jashtëm gjerman vjen në një kohë kur 3 vende të Bashkimit Evropian janë shprehur skeptike për hapjen e negociatave për Shqipërinë. Franca, Holanda dhe Gjermania janë shprehur se Shqipëria duhet të bëjë ende progres në forcimin e shtetit ligjor dhe luftën kundër krimit dhe korrupsionit. Në 28 qershor pritet të bëhet publik vendimi i vendeve anëtare të BE-së për Shqipërinë pas rekomandimit të Komisionit Evropian për çeljen e negociatave.

PARALAJMËRIMI

Komisioneri për Zgjerimin, Johannes Hahn kundërshtoi hapur idenë për ndërtimin e një kampi refugjatësh në Ballkan për emigrantët nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut. "Unë paralajmërova që në valën e parë në vitin 2015 që vendet në rajon, të cilat nuk janë anëtare të BE nuk mund të bëhen parking për refugjatët", deklaroi Hahn.

Pak ditë më parë Christian Lange, sekretar parlamentar i shtetit në Ministrinë e Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit deklaroi në Tiranë se arrestimi i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri dhe largimi nga detyra i ministrit aktual të Brendshëm, Fatmir Xhafaj nuk janë kusht për hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Lange i bëri thirrje politikës shqiptare të luftojë korrupsionin, të vijojë thellimin e reformave dhe të shmangë bllokadat, si tre elementë të përbërës të rëndësishëm për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian.



Shehi: Opozita me të dyja duart për Evropën, të hapen negociatat

Deputeti opozitar, Dashamir Shehi beson se Ballkani ka nevojë të integrohet. Sipas tij, kjo u bë një histori shumë e stërgjatë dhe ata e kanë kuptuar që Ballkani po lodhet. "Europën po e zëvendësojnë dy faktorë anti-europian (Turqia dhe Rusia) në Ballkan. Europa e ka kuptuar që është më mirë të përshpejtojmë fazën e integritimit. I treti është se, e kanë kuptuar që nëse nuk futen vetë brenda këtu me policë, me prokurorët e me gjykatësit e vet, situata e kriminalizimit në Ballkan do të vazhdojë të rritet, do të ushqejë trafiket ndërkombëtare, për të cilin e paguajnë ata cminin", tha Shehi për "Report TV". Mazhoranca ka akuzuar opozitën se lobon kundër hapjes së negociatave, gjë të cilën Shehi e hedh poshtë me argumentin: "Ne opozitarët jemi me të dyja duart për Evropën. Për ne ka edhe një arsye të katërt, Europën e kemi aleat në luftën kundër kësaj qeverisje, e cila duke qenë jashtë Europës, bën siç ka qejf".

Lu: Shqipëria përballet me sfida të reja brenda dhe jashtë vendit

Ambasadori amerikan, Donald Lu përcolli dje një mesazh për të gjithë besimtarët myslimanë. Diplomati i lartë në vendin tonë, teksa përcjell një fotografi gjatë lftarit të shtruar në ambientet e ambasadës, thotë se Shqipëria po përballet me sfida të reja si brenda, ashtu edhe jashtë vendit. "Udhëheqja juaj është e rëndësishme për komunitetet tuaja, por edhe për Shqipërinë, ndërsa përballet me sfida të reja brenda dhe jashtë vendit. Viti i ardhshëm ju sjellë gëzim, begati dhe paqe! Gëzuar Bajramin!", shprehet ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu.

Kryeministri për median austriake: Italia nuk na kërkoi ekstradim të Agron Xhafajt

Rama: Gati t'i kthejmë shqiptarët që banojnë ilegalisht në Europë

"Nëse numri i refugjatëve rritet, do kërkojmë ndihmë nga BE"

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje në një intervistë për portalin austriak "Profil.at", se Italia nuk e ka kërkuar kurrë ekstradimin e vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe në këtë rast qeveria shqiptare nuk ka pasur çfarë të bëjë. Sa i përket provës që ka Shqipëria në fund të qershorit në Këshillin Europian për çeljen e negociatave, kryeministri thotë se është i gatshëm të heqë dorë, nëse kjo do të luftonte firmën populiste që po përhapet në Europë. Rama është ndalur edhe tek çështja e azilkërkuësve shqiptarë në vendet e BE-së, si një problem i ngritur nga vendet skeptike dhe ka thënë se Shqipëria është gati t'i kthejë të gjithë shqiptarët në atdhe, nëse BE e vendos si kusht për hapjen e negociatave.

INTERVISTA

Në fund të qershorit, Këshilli Evropian në Bruksel do të vendosë për hapjen ose jo të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Për momentin kjo gjë nuk duket shumë mirë.

Nëse vonesa e hapjes së negociatave për Shqipërinë do ta ndihmonte Bashkimin Europian të frenonte rritjen e populizimit në BE, atëherë unë jam gati. Por ne kemi bërë gjithçka që BE na ka kërkuar të bëjmë. Ne e ndryshuam Kushtetutën në ko-



tan, was die EU von uns verlangt hat"

LETRA PËR DIBRANËT

Kryeministri Edi Rama ka zgjedhur t'i ftojë dibranët për nisjen e punimeve për Rrugën e Arbrit me një letër me shkrim dore. "Çdo dibran që më ka ndërsur në 'FB' me sharje e tallje, për Rrugën e Arbrit, i ka hallall të gjitha po erdhi të dielën (10:30), e në Klos (12:00) për fillimin e punimeve të pritura 100 vjet. Fjalët mbrapsht kush nuk çon të paktën një buzëqeshje në 'FB' në pamundësi për të ardhur", ftoi dje Rama, dibranët në turin e tij të shtunë e të diel.

mpromis me opozitën, e cila nuk pajtohet me pothuajse asnjë çështje. Tani po vendosim në punë një sistem të ri emërimi për gjykatësit dhe prokurorët. Natyrisht, Shqipëria ka nevojë ende për shumë kohë për t'u bërë anëtare e BE-së, por ne nuk jemi aktualisht të interesuar për anëtarësim. Nisja e negociatave për pranimin do na ndihmonte për zbatimin e reformave.

Disa shtete si Franca, Holanda dhe Danimarka kanë ende rezerva për hapjen e negociatave të pranimit për Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Është e vështirë për mua të

kuptoj se pse vendimi i Komisionit të BE për të filluar bisedimet me ne nuk duhet të jetë detyrues për shtetet anëtare. Ne jemi gjithashtu të gatshëm t'i kthejmë bashkdhetarët që banojnë ilegalisht në Francë ose në vende të tjera të BE. Por besimi i shqiptarëve në BE dhe gjendja e mirë këtu do të dëmtohen. Nëse numri i refugjatëve rritet, ne presim ndihmë nga BE. Kjo është ajo që i thashë kancelarit federal, Kurz, në Vjenë.

Sipas kancelarit austriak, Sebastian Kurz, ekziston një rrugë e re kalimi në Ballkan për refugjatët nga Shqipëria dhe Bosnja.

Ne kemi të regjistruar rreth 2200 refugjatë nga Siria dhe Pakistani që nga fillimi i vitit. Ka rritje, por ende është një numër i vogël. Ne nuk duam të ndërtojmë barriera kufitare. Megjithatë, nëse rritet numri i refugjatëve, ne do presim ndihmë nga BE.

Ka akuza kundër ministrit të Punëve të Brendshme Fatmir Xhafaj, se ai ka mbrojtur të vëllain e tij, të dënuar për trafik droge.

Italia nuk ka kërkuar kurrë ekstradimin e tij. Çfarë duhet të bëjmë?

E ndaluar dot ju kultivimin në shkallë të gjerë të kanabisit në Shqipëri gjatë vitit 2016?

Ne e luftuam në mënyrë efektive. Por kush flet për problemet e drogës në Holandë apo në Francë? Gjithmonë të akuzuar jemi ne shqiptarët.

SHKURT

Petrit Vasili: Rama ka rrjedhur, kërkon t'i vërë rregulla BE-së

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, e cilësoi "të rrjedhur" kryeministrin Rama. Në një reagim të tij pas intervistës së Ramës për mediat e huaja, Vasili tha se ai kërkon tani që vendimi i Komisionit të BE-së për të filluar bisedime me Shqipërinë të jetë detyrues për të gjitha vendet. "Po ky i fandaksur do t'i verë rregulla të reja Europës, që të pranojë Shqipërinë ndryshe nga të gjithë të tjerët. Duhet të bëjë përjashtim Europë, meqë në krye të qeverisë së Shqipërisë gënjehet ky i tepsisë, që Europa mezi e ka pritur", u shpreh Vasili. Sipas tij, "integrimi evropian nuk është pazar, por përmbushje standardesh të demokracisë, qeverisjes, të zbatimit të ligjit, të luftës ndaj kimit dhe trafikëve, të zhvillimit ekonomik dhe të të drejtave të njeriut. Ky kërkon që të blejë parimet me pazare ordinere, ndaj edhe Shqipëria pengohet në integrimin evropian, demonizohet dhe dënohet".

Paloka për Rrugën e Arbrit: Qeveria "Berisha" bëri 60 për qind të punimeve

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Edi Paloka, e ka cilësuar tallje me dibranët njoftim që kryeministri Edi Rama u bëri dje në "FB" për nisjen e punimeve të Rrugës së Arbrit. Në reagimin për mediat, Paloka i drejtohet Ramës "ordiner", teksa i kujton se në 5 vjet nuk ka bërë asnjë investim, por vazhdon të presë shirit nga punët e nisura nga qeveria "Berisha". "Ordiner...! Shpresoj që dibranët të ta kthejnë përgjigjen siç e meriton e siç dinë ata. Ka pesë vjet që nuk bën asnjë punë. Vetëm llogje e guxon dhe të ironizojë ata që e kanë akuzuar për këtë. Të vetmet 'inaugurime' që ka bërë në 5 vjet kanë qenë investime të projektuara, financuara dhe iniciuara nga qeveria 'Berisha', u shpreh dje Paloka. "Pasi i gënjeu për 5 vjet me radhë dibranët, tani flet me paturpësi për fillimin e punimeve, të pritura për 100 vjet. Ti e do një përgjigje, tamam si prej Dibre, e shpresoj që dibranët të ta japin", iu drejtua Paloka kryeministrit Rama.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR TENDER

1. **GENERAL CONDITIONS**
 - 1.1. **Requester:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Country Office Albania in Tirana, Rr. Skenderbej, Nr 21/1.
 - 1.2. **Profile:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, is an experienced service provider and assists the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation. GIZ offers demand-driven, tailor-made and effective services for sustainable development
 - 1.3. **Subject:** The GIZ Office Tirana invites authorized and registered companies to express their interest in providing one off-road vehicle (4x4).
 - 1.4. **Companies should fulfill the following requirements:**
 - 1) Be an authorized and licensed dealer/partner from the manufacturer. According certificate must be provided.
 - 2) Provide a warranty up to 100.000 km drive for the vehicle.
 - 3) Offer quality service for the vehicle within the warranty duration. All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de
 - 1.5. **Due date for submitting the application and offer is 21.06.2018.** The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: **"PROVISION OF Off-Road Vehicle (4x4)"**, addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbej, Nr 21/1 Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi catering ne ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë 1 vjeçare"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **10,200,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi catering ne ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë 1 vjeçare"**
Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Korrik 2018, ora 10:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Infrastruktura/ Shtohet me 30% vlera e produkteve bujqësore

Ornela Manjani

Fondi Shqiptar i Zhvillimit me mbështetjen e Bankës Botërore ka kryer një studim mbi impaktin e rrugëve rurale në Shqipëri. Referuar studimit, është vërejtur se në zonat rurale ku ka pasur investime në infrastrukturë rrugore, prodhimi bujqësor është rritur dhe diversifikuar në masën 30%, kostot e prodhimit janë ulur me rreth 15% dhe punësimi është rritur në masën rreth 13%. "Studimi u shtri në të gjithë vendin dhe mbulon një periudhë 5-vjeçare (2012-2016). Qëllimi ishte matja e impaktit që programi "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale" (PRDL) kishte në periudhën afatmesme në zonat përfituese. Analiza bazohet në studimin e ekonomive familjare të administruara në një kampion prej rreth 2,000 familjeve që jetojnë në 144 fshatra në 12 qarqe dhe konsultim me 10 fokus-grupe në të dyja fazat e studimit 2012 dhe 2016. Në Shqipëri janë rreth 10,000 km rrugë rurale që administrohen nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të nivelit të parë e të dytë. Disa nga gjetjet më interesante të studimit kanë të bëjnë me përmirësimin e ndjeshëm të aksesit nga infrastruktura arsimore dhe shëndetësore, rritjen e vlerës së tokës në zonat që u prekën nga programi dhe rritja e të ardhurave familjare për shkak të shkurtimit të distancës mes fermerëve dhe pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore" njofton FSHZH. Sa u përket gjetjeve, ka rezultuar se "kohera e udhëtimit në spital u reduktua me 27% në komunitetet e përfituese". "Banorët e komuniteteve përfituese kanë 12% për qind më shumë

Studimi i BB: Ndërtimi i rrugëve rriti me 48% vlerën e banesave

Studimi për impaktin e sistemimit të rrugëve dytësore



mundësi të vizitojnë qendrat shëndetësore, në rast të nevojave të vogla mjekësore në krahasim me komunitetet jopërfituese. Për më tepër, koha e udhëtimit dhe shpenzimet e udhëtimit në shkollat e mesme u zvogëluar me 31% dhe 54% respektivisht, si rezultat i përmirësimit të kushteve të rrugës" shkruhet në studim. Po ashtu, vërehet se investimet në infrastrukturë kanë pasur ndikim të rëndësishëm dhe pozitiv në vlerat e tokës truall dhe bujqësore. Vlera mesatare e banesave është rritur me 48%, ndërsa çmimi i tokës bujqësore është 1.2 herë më i lartë në komunitetet përfituese në krahasim me komu-

nitetet jopërfituese. Fermerët në zonat përfituese arrijnë më shpejt tregjet e produkteve bujqësore, ndërkohë që kostot e inputeve bujqësore dhe prodhimi bujqësor janë ulur. Prodhimi dhe diversifikimi i kulturave bujqësore është gjithashtu më i lartë 34,2% më i lartë në komunitetet e përfituese krahasuar me komunitetet jopërfituese. Analiza e të dhënave statistikore dhe intervistave të zhvilluara në terren vë në dukje se investimet në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore Lokale kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e perspektivave të punësimit të kryefamiljarit. "Shkalla e papunësisë e kryefamiljarëve

është 12.6 për qind më e ulët dhe vetëpunësimi është rritur me 12.9 për qind në komunitetet përfituese. Në shkallë më të gjerë, vërehet se investimet kanë pasur ndikim pozitiv edhe në ekonominë lokale. Tregues për këtë është rritja e shpenzimeve të konsumit të familjeve. Rezultoni se pas investimit, në komunitetet përfituese shpenzimet totale familjare (ushqimi dhe shpenzimet joushqimore) janë 25% më të larta. Një fakt interesant i zbuluar nga analiza është se ndërsa zëri i shpenzimeve ushqimore në komunitetet përfituese nuk ka pasur ndryshime, shpenzimet joushqimore (veshje, pajisje, aktivitete) janë rritur me 58%. Ky fakt flet për një rritje të cilësisë së jetesës në komunitetet përfituese", - bën të ditur FSHZH.

Programi për ndërtimin e rrugëve

Programi i Rrugëve Dytësore Lokale u konceptua në kushtet në një situatë kur investimet në rrugët dytësore dhe lokale ishin të copëzuara dhe mbi 70% e rrugëve ishin në gjendje të keqe apo shumë të keqe. Shtyllat kryesore mbi të cilat u ndërtua programi ishin: ngritja e një sistemi funksional të inventarizimit të rrjetit rrugor dhe prioritizimin e investimeve; rehabilitimi në shkallë të gjerë të rrjetit rrugor dytësor dhe lokal, ku u përfshinë 144 segmente rrugore dhe ura në një total prej 1,200 km dhe stabilizimi i proceseve të funksionimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti rrugor. Krahas financimit të qeverisë shqiptare dhe Bankës Botërore, programi arriti të sigurojë një financim prej 368 milionë USD të institucioneve të tjera financiare si OFID, CEB, BEI, BERZH, BE (IPA 2008-2011, EBIF), IDB, KfW. Mbi 1,200 km rrugë dytësore dhe lokale u rehabilituan, duke e shndërruar Programin e Rrugëve Dytësore në një nga programet me impaktin më të lartë në vend.

Ministri i Infrastrukturës inspekton punimet

Gjikhuri: Brenda vitit rinis puna në 'bypass'-et Fier dhe Vlorë

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri, inspektoi dy kantieret të Autoritetit Rrugor Shqiptar në zonën e Fierit. Në fillim, ai ndaloi në aksin nga rotondo e Kolonjës deri në Mbrostar, ku po kryhet rehabilitimi për të parandaluar degradimin e standardit të rrugës. Më pas, ministri Gjikhuri ishte në Unazën Lindore të qytetit të Fierit, ku ka nisur puna për rehabilitimin e plotë të segmentit nga rrethi-rrrotullimi i Patosit deri në ish-QTU. Projekti parashikon më tej ndërhyrjen rehabilituese deri në Levani, ku bëhet lidhja me autostradën Fier-Vlorë. "Këtu siç e shikoni, ka qenë një segment jashtëzakonisht problematik dhe besoj se në krye të dy javëve, ajo pjesë e segmentit që po

punohet do të jetë tërësisht e rinovuar. Me Bashkinë e Fierit dhe me policinë jemi duke punuar që një pjesë e trafikut të devijohet brenda qytetit. Edhe njëherë u kërkojmë ndjesë qytetarëve, por njëkohësisht edhe të na mirëkuptojnë. Është një periudhë shumë e shkurtër, por përfitimi do të jetë shumë i madh. Korriku dhe gushti që janë edhe muajt kulmor të sezonit do të kenë rrugë shumë më të mira dhe diferenca do të jetë e jashtëzakonshme", u shpreh ministri Gjikhuri. Ai gjeti rastin që të ndajë me publikun edhe një lajm të mirë sa u takon projekteve të mbetura pezull për ndërtimin e "bypass"-eve të Fierit dhe Vlorës. "Dua të jap edhe një lajm të mirë që sot përfundoi edhe parakualifikimi i fazës së parë të dy 'by-

pass'-eve, ai i Fierit dhe ai i Vlorës. Këto ditë do të hapet tenderi për fazën përfundimtare, që është dorëzimi i ofertave financiare dhe jam besimplotë që brenda këtij viti ne do të fillojmë punimet edhe në këto dy 'bypass'-e të rëndësishme. Shpresojmë që 'bypass'-i i Fierit vitin tjetër të jetë i përfunduar, kurse 'bypass'-i i Vlorës do të dojë më shumë kohë. Ajo çka është e rëndësishme është se edhe kësaj gangrene të infrastrukturës për shumë vite, ne i dhamë zgjidhje. Pra u prish kontrata, u siguruan të gjitha të drejtat juridike, u fillua procedura e re dhe kjo po shkon drejt përfundimit. Një procedurë kompetitive, transparente dhe e monitoruar nga BERZH-i si institucioni financiar i këtij projekti", nënvizoi Gjikhuri.



Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojnë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

Paketat Super	Super 500	Super 700	Super 1100	Super 1300	Gigastike	Super 1900
Çmimi (me TVSH)	500 Lekë	700 Lekë	1,100 Lekë	1,300 Lekë	1,300 Lekë	1,900 Lekë
Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse)	300	200	2500	3000	400	3500
Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks	300	400	500	3000	400	3500
Minuta Ndërkombëtare				30		60
SMS drejt ALBtelecom Mobile	300	400	1000	2500	400	3000
SMS Kombëtare			500	400		300
SMS Ndërkombëtare						
Internet 3G/4G		300 MB	3 GB	5 GB	5 GB	12 GB
Internet 3G/4G+						3 GB
Përfitime të tjera					10 GB (Social In Chat)	
TV				ALBtv Mobile	ALBtv Mobile	ALBtv Mobile
Vlefshmëria	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.*

4 rastet/ Si u kap hashashi në vendin fqinj. Gjergji Kohila bashkëpunoi me grupin


Ina Allkanjari

Disa muaj pas shpalljes në kërkim të tre ish-zyrtarëve të lartë të policisë së Vlorës në kuadër të hetimit të dosjes "Habilaj", "Gazeta Shqiptare" siguron pjesë nga dosja e prokurorisë së krimeve të rënda, ku përmenden rolet e tyre dhe përfshirja në grupin e trafikimit të drogës. Bëhet fjalë për ish-drejtorin e policisë së Vlorës, Jaeld Cela, shefin e sektorit të luftës kundër krimit të organizuar në drejtorinë e qarkut Vlorë, Gjergji Kohila si dhe ish-drejtorin e Postës së Dhërmit, Sokol Bode. Në dosjen hetimore shpjegohet se si grupi hetimor ra në gjurmët e tre ish-zyrtarëve. Gjithashtu, tregohen lidhjet që kanë mbajtur me trafikantët Habilaj. Sipas organit të akuzës, Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit për kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike dhe trafikimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit. "Nga hetimet e kryera rezultojnë se pjesëmarrës të këtij grupi kriminal janë dhe shtetasit Sokol Bode, me detyrë shef i stacionit të policisë Dhërmi, i cili ka mbajtur lidhje duke i ofruar ndihmë dhe mbështetje anëtarëve të këtij grupi kriminal me qëllim realizimin e trafikimit të narkotikëve nga Shqipëria drejt Italisë", thuhet në dosjen hetimore. Nga ana tjetër një rol aktiv siç thuhet në dosje rezultojnë të ketë pasur edhe shefi i Hetimit të Narkotikëve dhe Trafiqeve Gjergji Kohila, i cili thuhet të ketë bashkëpunuar drejtpërdrejt me trafikantët. "Po ashtu rezultojnë se ka dyshime për faktin se shtetasi Gjergji Kohila, me detyrë shef i Sektorit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë ka mbështetur dhe ka bashkëpunuar me anëtarët e këtij grupi kriminal në kultivimin e bimëve narkotike dhe me pas trafikimin e saj", sqarohet në dosje. Më tej në dosje përmendet drejtori i drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë, Jaeld Cela, i cili dyshohet se bashkëpunonte me anëtarë të grupeve kriminale për kultivimin e bimëve narkotike dhe me pas trafikimin e saj. "Nga hetimet e kryera rezultojnë se shtetasi Jaeld Cela, me detyrë drejtor i drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë, në bashkëpunim me punonjësit e policisë Gjergji Kohila, Sokol Bode dhe punonjësit e policisë së Shqipërisë, thuhet në dosjen e prokurorisë.

ISH-ZYRTARËT
Prokuroria e Krimeve të rënda në vijim të hetimeve për dosjen "Habilaj", ka shpallur në kërkim tre ish-zyrtarët

Dosja "Habilaj", prokuroria: Policia ndihmoi trafikun e drogës me Italinë

"Bashkëpunim me njerëz që ushtrojnë funksione publike"



MOISI HABILAJ

Në dosjen e prokurorisë sqarohet se nga aktet e administruara në këtë procedim penal ka rezultuar se nga autoritetet italiane të drejtësisë është arrestuar shtetasi Moisi Habilaj dhe disa persona të tjerë, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të trafikimit të narkotikëve, kryer në bashkëpunim në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal.

e policisë së Vlorës. Konkretisht ish-drejtorin e policisë së Vlorës, Jaeld Cela, shefin e sektorit të luftës kundër krimit të organizuar në drejtorinë e qarkut Vlorë, Gjergji Kohila si dhe ish-drejtorin e Postës së Dhërmit, Sokol Bode. Masa e ndalimit ndaj tre ish-zyrtarëve është dhënë pasi akuzohen për mosveprim ndaj kultivimit të kanabis sativës në këtë qark, duke lejuar trafikimin e drogës së Habilajve në drejtim të Italisë. Urdhër arrestet e lëshuara nga Prokuroria e Krimeve të Rënda i janë dërguar për ekzekutim Policisë së Shtetit. Por policia ngriti dyshime se operacioni është dekonspiruar. Kjo për faktin se nuk është kryer ende asnjë arrestim pasi asnjë nga ish-zyrtarët nuk është gjetur. Ministria e Brendshme reagoi duke sqaruar se pavarësisht kontroleve të ushtruara në baneza dhe vende ku dyshohet se mund të strehoheshin ish-zyrtarët, Cela, Bode dhe Kohila, nuk është bërë e mundur gjeta dhe ndalimi i tyre. Ndaj tyre u mor vendimi për përjashtim nga radhët e Policisë së Shtetit. Mësohet se Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, kërkoi sqarime nga vartësit e tij, pasi dyshohet se oficerë apo zyrtarë të tjerë dekonspiruan operacionin, ku u bë i mundur dhe largimi i ish-zyrtarëve. Bëhet me dije se shumë pak

persona kanë pasur dijeni për emrat e ish-zyrtarëve që kërkoheshin për t'u vënë në arrest. Mësohet se ish-drejtori i policisë së Vlorës, Jaeld Cela, është shkarkuar nga detyra në prill të vitit të kaluar me vendim të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Cela ka drejtuar policinë e Vlorës nga shtatori i 2014 deri në prill 2017. Ndërkohë ish-drejtori i Postës së Dhërmi, Sokol Bode ka qenë prej kohësh në vëmendje të publikut dhe medias, pas publikimit të një foto ku shihej përkrah Florian dhe Moisi Habilajit. Tre ish-zyrtarët akuzohen për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Trafikim të narkotikëve", të kryer në bashkëpunim në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal.

DOSJA "HABILAJ", ARRESTIMET

Më datë 17.10.2017, prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, Tiranë ka regjistruar procedim penal për veprat "Trafikim i narkotikëve", kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal. "Korupsioni pasiv i funksionarëve të lartë ose i të zgjedhurve vendorë". Në dosjen e prokurorisë sqarohet se nga aktet e administruara në këtë procedim penal ka rezultuar se nga autoritetet italiane të drejtësisë është ar-

restuar shtetasi Moisi Habilaj dhe disa persona të tjerë, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të trafikimit të narkotikëve, kryer në bashkëpunim në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal. Arrestimi i këtij shtetasi

"Nga hetimet e kryera rezultojnë se pjesëmarrës të këtij grupi kriminal janë dhe shtetasit Sokol Bode, me detyrë shef i stacionit të policisë Dhërmi, i cili ka mbajtur lidhje duke i ofruar ndihmë dhe mbështetje anëtarëve të këtij grupi kriminal me qëllim realizimin e

është bërë në funksion të hetimeve që autoritetet italiane po zhvillojnë në lidhje me faktin e sekuestrimit të sasisë së lëndës narkotike të llojit Kanabis Sativa prej 3.5 ton. Nga hetimi rezultojnë se shteta-

BASHKËPUNIMI

Në dosjen hetimore shpjegohet se si grupi hetimor ra në gjurmët e tre ish-zyrtarëve Jaeld Cela, Gjergji Kohila dhe Sokol Bode. Gjithashtu, tregohen lidhjet që kanë mbajtur me trafikantët Habilaj. Sipas organit të akuzës, Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit për kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike dhe trafikimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit.

Vogël, është gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale një mjet lundrues, gomone, me mbishkrimin "Wave", mbi të cilën ndodhej një motor së bashku me karelin metalik, i cili kishte të montuar dy goma. Sipas dokumentacionit mjeti lundrues rezultoi në emër të shtetasit Ferdinand Habilaj, por që i ishte lënë në përdorim shtetasit Moisi Habilaj. "Nga aktet e letërporsisë të dërguar nga autoritetet italiane të drejtësisë rezultojnë se është arrestuar personi në hetim Moisi Habilaj dhe disa persona të tjerë si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të "Trafikimit të narkotikëve kryer në bashkëpunim, në formë të posaçme të grupit të strukturuar kriminal". Arrestimi i këtyre shtetasve është kryer në funksion të hetimeve e autoritetet italiane të drejtësisë po zhvillonin në lidhje me kapjen dhe sekuestrimin e sasisë prej 3.5 tonësh lëndës narkotike e llojit kanabis sativa në territorin e shtetit italian. Konkretisht, nga autoritetet ligjzbatuese italiane, grupit kriminal me organizator shtetasin Moisi Habilaj, i janë sekuestruar lëndë narkotike në katër raste", thuhet në dosjen e prokurorisë.

SEKUESTRIMET E DRGËS

Rasti i parë është në datë 25.10.2013 ku në vendin e quajtur Augusta janë sekuestruar 1650 kg lëndë narkotike kanabis sativa, rasti i dytë më datë 27.02.2014 në vendin e quajtur Palogonia ku u sekuestruan 290 kg lëndë narkotike kanabis sativa, rasti i tretë më datë 29.07.2014 në qytetin e Catanias ku u sekuestruan 294 kg lëndë narkotike kanabis sativa dhe dy armë luftarake automatike. Nga hetimet e kryera rezultojnë se shtetasi Moisi Habilaj në bashkëpunim me persona të tjerë, të cilët ushtrojnë funksione publike në Republikën e Shqipërisë ka arritur të trafikojë jashtë shtetit me destinacion Italinë, sasi të konsiderueshme lëndë narkotike. Personi në hetim Moisi Habilaj dhe bashkëpunëtorët e tij kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të policisë së shtetit për kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike dhe trafikimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit.

Tragedia në "Don Bosko"/Taip Mata: Policia dhe prokuroria s' reagan, ngjarja mund të ishte parandaluar

Rrëfihet babai i Xhaferr Matës: Familjes së Xhuljetës i kam shtirë dorën e faljes

"Dhimbja është e dyfishtë. Djali im iku, por preu edhe një jetë në mes, pres pajtim"

Klodiana Lala

TIRANË

Një makinë policie qëndron e stacionuar 24 orë përpara derës së Taip Matës. Sapo kapërcen portën e hekurt të shtëpisë dykatëshe, kupton se dhimbja dhe tensioni janë përzier bashkë. Vëllai i Xhaferr Matës, djali që vrau ish-të dashurën dhe veten mëngjesin e 8 qershorit, nuk e pret mirë mbërritjen tonë. "Kemi folur me z.Taip, babain tuaj", i themi në hyrje. "Po ju pret në katin e dytë", përgjigjet zymtë. Taip Matën e gjejmë të ulur në një nga divanet e dhomës së mbytur nga tymi i duhanit. Ai s'e lëshon cigaren nga dora, a thua se e ndihmon të largojë dhimbjen. "Kam jo vetëm dhimbjen për humbjen e djalit, por vuaj njësoj edhe humbjen e Xhuljetës. Është njësoj si të kem humbur vajzën time. Por ndodhi, s'e zhbëj dot më", thotë ai. Pak çaste dhe në derë shfaqet motra e 31-vjeçarit. Sytë i ka të ënjtur nga lotët e mezi arin të nxjerrë fjalë nga goja. Në dhomën e pritjes nuk ka qoftë edhe një foto të Xhaferrit, por babai thotë se "ja aty poshtë, kam gjithçka prej tij". Bëhet fjalë për servisin ku 31-vjeçari, baba i një djali të mitur kishte ngritur ngjitur me shtëpinë. "Punonte aty tërë kohës", thotë Taip Mata. Ai ka shumë për të rrëfyer për jetën e të birit. Nis të tregojë historinë e tij, njohjen me bashkëshorten, lindjen e djalit të tyre, tashmë dy 2 vite e gjysmë, problemet mes djalit dhe nuses, njohjen e tij me Xhuljetën e shumëçka.



Taip Mata duke folur për "GSH"

Por një moment hesht. "Nuk dua të lëndoj familjarët e vajzës. U kam shtirë dorën e faljes. Kam kërkuar prej tyre ta ndajmë dhimbjen bashkë", shprehet kryefamiljari.

Z.Mata, dua ta nis me ju këtë bisedë, duke të kërkuar të më flasësh për djalin tuaj të ndjerë, Xhaferrin. Si ishte jeta e tij?

Xhaferrri ishte njëri nga katër djemtë e mi. Kam edhe një vajzë. Pasi mbaroi fakultetin për Inxhinieri, ai hapi servisin këtu ngjitur me shtëpinë dhe merrej me makinat. U njoh edhe me të shoqen dhe u martua. Fillimisht marrëdhëniet mes tyre ishin të mira. Ajo ngeli shtatzënë dhe lindi djalin. Sot nipi im është 2 vjeç e gjysmë. Xhaferrri s'më kishte sjellë më herët shqetësime. Punonte fort dhe e nxirrte vetë bukën. Me nusen filluan të grinden. Ajo ishte 19 vjeçe dhe martesa mes tyre nuk po ecte mirë. Bëmë përpjekje disa herë me pleqësi për t'i bashkuar, por në fund vendosi të ndahej. Nusia ishte xheloze, pasi kishte mësuar për marrëdhënien e

TAKIMI ME XHULJETËN

"I kërkova dhe u takuam. E morëm në makinë. Isha unë bashkë me gruan, Xhaferrri dhe djali i vogël. Shkuam në një lokal tek Fusha e Aviacionit. Aty bisedova për herë të parë me Xhuljetën. Edhe i fola pak. I thashë si ka mundësi që një vajzë se ti, me gjithë të mirat, është lidhur me djalin tim që ka edhe fëmijë. Më tha e dua Xhaferrin. I kërkova atëherë të shkonte e ti tregonte familjes së saj. Hezitoi dhe kjo s'më pëlqeu shumë", tha dje për "GSH", Taip Mata.

Xhaferrit me Xhuljetën. Debatet mes tyre shtoheshin dita-ditë, kur Xhuljeta u punësua në marketin afër shtëpisë sonë. Megjithatë, në fund u ndanë.

Ju po flisni për një marrëdhënie mes djalit tuaj dhe Xhuljetës. Si qëndron e vërteta e kësaj historie?

Do të flas për çfarë di unë. Para disa kohësh, punoja këtu poshtë shtëpisë me kamion. Njëri nga kolegët pa Xhuljetën të kalonte dhe më tha: "Kjo vajza shqërohet me Xhaferrin". S'e besova. Djali im ishte i martuar. Por, prapë nga ai moment u vura në lëvizje. Doja të bindesha vetë fillimisht se një gjë e tillë ishte e



31-vjeçari Xhaferr Mata



Viktima Xhuljeta Çuni

Xhaferrin. Ai filloi të rrinte mënjatë, ishte i tensionuar. Bëmë edhe debat gjatë kësaj kohe. E shihja që nuk ishte mirë. Lëvizte nëpër oborr, s'kishte përqendrim në punë. Por fliste pak. Një ditë më tha që me Xhuljetën kishte bërë fjalë. Lidhja nuk do të vazhdonte, por ajo duhet t'i kthente 2 milionë lekë të vjetra që ai ia kishte dhënë. I kërkoja t'i harronte lekët. Ta mbyllte atë histori për hir të shumë gjërave e të vazhdon të përpara. Debatuam shumë. Ishte ulur në këtë kolltuk (tregon me dorë, kolltukun ngjitur me divanin ku ishte ulur vetë). Shpërtheu në lot. S'e kisha parë kurrë në atë gjendje, sepse ai ishte djale me sedër. Bëri një veprim që s'e kishte bërë kurrë në jetë. Me tregoi derën, më tha dil. E bëri besoj nga dëshpërimi, pasi s'po e përballoste dot gjithçka kishte ndodhur. I thashë gruas që djali nuk është mirë. Në situatën ku ishte, nuk u mërzi ta më të. Ika bashkë me gruan dhe djalin e vogël të Xhafës në Kukës. Bëhet fjalë pak ditë përpara ngjarjes. Më tha se kishte bërë denoncim në polici. Edhe vajza e kishte denoncuar.

Folët me të gjatë kësaj kohe?
Më telefonoi vetë dy ditë rresht. Më pyeste kur do ktheheshim. E ndjeva se diçka nuk shkente dhe i kërkoja gruas të bëhej gati, se do të vinim në Tiranë. Kemi ardhur natën para se të ndodhte ngjarja. U kënaq shumë që takoi djalin. Por unë fola shumë pak me të. Mëngjesin e asaj dite doli nga shtëpia që në orën 06:00. Unë dola të pija një kafe dhe i telefonova dy herë. S'm'u përgjigji. I dërgova mesazh dhe prapë

nuk reagoi. U shqetësova shumë. U ngrita dhe shkova në shtëpi, po merresha me kamionin. Më telefonoi një shoku im dhe më pyeti për Xhaferrin se ku ishte. Iu përgjigja se: "as mua s'po më përgjigjeje në telefon". Më tha ka ndodhur diçka e keqe. U ngjita në katin e dytë të shtëpisë dhe hapja televizorin. Kishte ndodhur gjëma. Më pas shkova në polici. Aty kam dhënë shpjegimet.

Ju thathë që ishin bërë dy denoncime si nga vajza, ashtu edhe nga Xhaferrri. Keni dijeni nëse djali juaj u mor në pyetje nga prokuroria?

Po, është marrë në pyetje më datë 26 maj. Dy apo tri ditë përpara ishte marrë në pyetje edhe vajza. Besoj se policia dhe prokuroria kanë gabuar, pasi s'kanë marrë kontakte me familjen e vajzës. Aty do të mësonin të gjithë të vërtetën. Ngjarja mund të parandalohet.

Po për armën, keni dijeni ku mund ta ketë gjetur djali juaj?

Ne armë në shtëpi nuk kemi pasur. Po mendoj se Xhafa e ka gjetur nga ndonjë mik i tij.

Me familjen e Xhuljetës keni pasur kontakte pas kriminit. U keni kërkuar falje?

Ne po e vuajmë dhimbjen e tyre. Ne na iku djali, por ai mori edhe një jetë. Humbjen e Xhuljetës e barazoi njësoj me humbjen e vajzës sime. Për këtë dhimbja është e dyfishtë. Kam shtirë dorën e pajtimit. U kam çuar në shtëpi dajën e Xhafës e një kushëri timin për t'u kërkuar ta ndajmë dhimbjen bashkë. Nuk kemi ende një përgjigje prej tyre. Nëse pranojnë të takohemi, faljen do t'ua kërkoj i ulur në bisedë.

NJOFTIM

SHPALLJA E VENDEVE TE PUNES PER ADMINISTRATOR

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë shpall konkursin për tre pozicione pune:

1. Administrator në Fakultetin e Mjekësisë
2. Administrator në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknikë
3. Administrator në Fakultetin e Mjekësisë Dentare

Afati i pranimit të dokumentacionit deri në datë 26.06.2018.

Informacioni i detajuar për kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar gjendet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë www.umed.edu.al dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

“Mos harroni të paraqitni kërkesën para 24 korrikut. Mbrojtja e gjuhës, domosdoshmëri”

Voltiza Duro

Faza e parë për të studiuar në Itali, dokumentacioni

Aliaj: Ja degët për nivelin Bachelor dhe Master

Të gjithë ata që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në një nga programet e studimit në ciklin e parë apo të dytë në universitetet italiane, kanë afat deri në 24 korrik të këtij viti për të paraqitur kërkesën për pararegjistrim. Në kërkesë duhet të shënohet qartësisht vetëm një degë universitare e më tej prezanton të gjithë dokumentacionin që duhet dorëzuar pranë ambasadës italiane të Tiranës apo Konsullatës Italiane në Vlorë. Ndërkohë dokumentet e shkollës së mesme duhet të vuloen pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe pranë Ministrisë së Arsimit e më pas të apostolohen pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të përkthehen në gjuhën italiane nga njëri prej përkthyesve. E pyetur nga ‘Gazeta Shqiptare’, drejtuesja e INAS Albania, Beskida Aliaj bën me dije për të interesuarit se mbrojtja e certifikuar e gjuhës italiane është e domosdoshme, e më tej tregon se studentët kanë mundësi të aplikojnë për një shumëllojshmëri degësh në një nga universitetet italiane. Fazën e parë, studentët paraqesin dokumentacionin e kërkuar e më tej ky informacion merret në shqyrtim deri në kthimin e një përgjigjeje përfundimtare mbi aprovimin ose jo të kërkesës.

FAZA E PARË

Faza e parë që do i nënshtrohen të interesuarit është paraqitja e kërkesës për pararegjistrim. Brenda datës 24 korrik 2018 studentët që dëshirojnë të fillojnë procedurën e pararegjistrimit, duhet të shkarkojnë dhe të plotësojnë dokumentin Excel, pastaj ta ruajnë me emrin: Preiscrizione Cognome Nome (mbiemri, emri i studentit) dhe ta dërgojnë të bashkëlidhur në emailin: scuole.tirana@esteri.it, me objekt: Preiscrizione 2018 Cognome Nome (mbiemri, emri i studentit). Më tej studentët duhet të caktojnë në kohë një takim pranë ambasadës italiane përmes faqes në internetit: <https://prenotaonline.esteri.it>.

Në kërkesë duhet të shënohet qartësisht vetëm një degë universitare, ndërkaq, studentët që nuk zotërojnë më dëftesën origjinale do të dorëzojnë një vërtetim me rezultatet e të gjithë viteve bashkë me ato të Maturës Shtetërore dhe fotokopje të thjeshtë të gjitha faqëve para-mbrapa. “Theksoj dhe faktin se të



Drejtuësja e INAS Albania, Beskida Aliaj



VULA PRANË MASR

Dokumentet e shkollës së mesme duhet të vuloen pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale dhe pranë Ministrisë së Arsimit. Më pas, dokumentet duhet të apostolohen pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të përkthehen në gjuhën italiane.

MUNGESA E TË DHËNAVE

Nëse diplomat universitare apo lista e notave nuk kanë të dhënat personale të plota dhe numër regjistrimi ose diplome, duhet të paraqitet edhe një vërtetim lëshuar nga universiteti, i cili i përmban ato, si dhe të dhënat e degës së studimit.

gjithe studentët e mitur duhet të jenë të shoqëruar nga të dy prindërit (ose nga njëri prej prindërve i pajisur me autorizimin e prindit tjetër) në momentin e paraqitjes së kërkesës së pararegjistrimit bashkë me një certifikatë familjare (modeli shumëgjuhësh) të apostiluar, -bën me dije Aliaj.

PROGRAMET ESTUDIUMIT

Studentët e interesuar kanë mundësi të aplikojnë për një shumëllojshmëri degësh në një prej universiteteve italiane dhe mund t'i shohin këto programe te linku përkatës. Studentët që dëshirojnë të regjistrohen “NË DEGËT ME NUMËR TË MBYLLUR” (janë programet që duhet ti nënshtrohen një provimi pranimi me detyrim) duhet të regjistrohen për të dhënë

provimin e pranimit edhe në faqen eëe.universitaly.it. Kjo vlen për degët Mjekësi e Kirurgji, Mjekësi dhe Kirurgji në anglisht për universitetet që e parashikojnë. Dentist dhe Proteza Dentare, Veterinari, Arkitekturë, Profesionet Shëndetësore si dhe Shkencat e Edukimit Fillor. Kurset e ciklit të zakonshist zgjasin tre vjet, ndërsa kurset e masterit kategorizohen në diplomë Master prej dy vjetësh pas Bachelorit; si dhe diplomë Master me një cikël të vetëm me kohëzgjatje pesëvjeçare ose gjashtëvjeçare si dega Mjekësi e Kirurgji, Stomatologji, Mjekësi veterinare, Arkitektura me një cikël apo Juridik.

DOKUMENTACIONI

Dokumentet duhet të paraqiten në zarf të tejdukshëm ku studentët duhet të

kenë përfshirë pasaportën dhe një fotokopje të saj me vlefshmëri të paktën 90 ditë nga vlefshmëria e vizës; certifikatën e lindjes (modeli shumëgjuhësh) e apostiluar; si dhe një formular regjistrimi (Mod.A), në tre kopje tërësisht i plotësuar, por i pa firmosur. Gjithashtu, studentët duhet të paraqesin edhe një formular të autentifikimit të fotografisë, në tre kopje tërësisht i plotësuar, por i pa firmosur; si dhe 4 fotografi me ngjyra për dokument. “Të interesuarit normalisht që duhet të dorëzojnë edhe diplomën e Maturës Shtetërore dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje e noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqëve para-mbrapa. Nxënësit e regjistruar në vitin e fundit të shkollës së mesme, që do të marrin dëftesën në verën e 2018-ës, do të paraqesin një fotokopje të thjeshtë të “Formularit A1” me të cilin janë regjistruar online për provimet e maturës 2018”, -bën me dije Aliaj. Pas marrjes së provimeve këta studentë duhet të dorëzojnë në ambasadë Diplomën e Maturës dhe certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje të noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqëve para-mbrapa. Ndërsa, studentët që janë

DOKUMENTACIONI PËR BURSA NË ITALI

- Certifikatë personale
- Certifikatë familjare: certifikatat vuloen në prefekturë; vule apostolike në Ministrinë e Jashtme; dhe të përkthyer.
- Kartela e vaksinimit: vulat në origjinal; firma tek ASHT; tek Instituti i Shëndetit Publik (Tek liceu); Ministria e Shëndetësisë; vule apostolike në Ministrinë e Jashtme; dhe të përkthyer.
- Raporti mjeko ligjor “I aftë për studime jashtë shtetit”: Vula e 3 specialisteve, vula e kontrollit të shëndetit publik; vula e Ministrisë së Shëndetësisë; vule apostolike në Ministrinë e Jashtme.
- Vërtetim të ardhurash: (Për personat e familjes që janë të punësuar ku të shkruhet paga mujore aktuale dhe të ardhurat vjetore të vitit të kaluar në lekë dhe në euro). Nëse është ent shtetëror, vula në ministrinë përkatëse, pastaj vula apostolike në Ministrinë e Jashtme. Nëse është ent privat, para se të dërgohet në Ministrinë e jashtme duhet të verifikohet firma pranë noterit.
- Vërtetim nga shkolla ose universiteti: (Nëse ndonjë nga pjesëtarët e familjes është në shkollë ose në universitet)
- Vërtetim të ardhurash nga pensioni (Nëse ndonjëri nga pjesëtarët e familjes merr pension): Vula në Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurimeve, vule apostolike në Ministrinë e Jashtme, dhe të përkthyer.
- Vërtetim të ardhurash të ndihmës ekonomike (Nëse ndonjëri nga pjesëtarët e familjes merr ndihmë ekonomike).
- Vërtetim si punë kërkues (Nëse ndonjëri nga pjesëtarët është i pa punë dhe nuk është në pension): Merr tek zyra e punës, vule në Ministrinë e Punës dhe vule apostolike në Ministrinë e Jashtme, dhe të përkthyer.
- Vërtetim hipoteke “Negativ” për student (që nuk posedon pronësi): Vuloset në sportelin e ambasadave në Hipotekë, vule në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të pasurive, vule apostolike në Ministrinë e Jashtme; dhe të përkthyer.
- Vërtetim hipoteke në emër të prindërve që posedojnë një shtëpi banimi: Vuloset në sportelin e ambasadave në Hipotekë, vule në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të pasurive, vule apostolike në Ministrinë e Jashtme; dhe të përkthyer.
- Vërtetim i tatim taksave që ka ose jo një biznes për prindërit: Merr në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, vule në Drejtorinë e Përgjithshme të tatimeve, vule apostolike në Ministrinë e Jashtme, dhe të përkthyer.

regjistruar këtë vit për të dhënë provimet me zgjedhje të Maturës Shtetërore duhet të dorëzojnë fotokopje të thjeshtë të “Formularit A1Z”. Pas marrjes së provimeve, këta studentë duhet të dorëzojnë në ambasadë Diplomën e Maturës dhe Vërtetim dhe Certifikatën e Maturës Shtetërore, në origjinal (ose fotokopje të noterizuar) bashkë me fotokopje të thjeshtë të të gjitha faqëve para-mbrapa.

Pembaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurine :

“Toke Are me sip 865 m² , me Nr pasurie 131/86 Zona kadastrale nr 1896 Volumi 9 , faqe 44 , me vendndodhje Grudë e re Shkoder .

2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkshkruar është në vlerën 336,000 (Treqind e tridhjetë e gjashtë mijë) Lekë .

Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me date 18.06.2018 ora 16.16 në Zyrën e pembaruesit gjyqësorë Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rrethit Gjyqësorë Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % te vlerës si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

EPSA SHQËRIA PËRMARUESË PRIVATE “E.P.S.A” SHPK NJOFTON SHIPALLJEN E ANKANDIT PËR :

1 - Trruall me sip. 100 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 1/460, Vol.42, Fq.74, e ndodhur ne Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar ne favor te TIRANA BANK sh.a. Çmimi me te cilin fillon ankand është 5.375.520 LEKË. Ankandi do te zhvillohet ne date 28.06.2018, ora 16.00 ne zyrën e shoqerise “EPSA” shpk te ndodhur ne Rr “Ismail Qemali”, Palli Fratarit, K.6, Tiranë.

2 - Trruall + Ndertese, me sip. 552 dhe ndertese 206.5 m², ZVRPP Tiranë, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 0/43, Vol.20, Fq.17, e ndodhur ne Tiranë. Kjo pasuri është e hipotekuar ne favor te TIRANA BANK sh.a. Çmimi me te cilin fillon ankand është 952.000 EURO. Ankandi do te zhvillohet ne date 13.07.2018, ora 16.00 ne zyrën e shoqerise “EPSA” shpk te ndodhur ne Rr “Ismail Qemali”, Palli Fratarit, K.6, Tiranë.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel: 04 24621171 ose ne www.epsa.al

Shitje me Ankand te Dyte nga Studio Pembarimore L.D.C

“Trruall me sip. 1,874m² nga e cila 250 m² është nderfese, me Nr. Pasurie 134033, vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier, Regjistruar ne Z. R. P. P. Fier ne emer te Shoq. Albjon shpk. Çmimi fillestar per shitje është 6.180.854 Lekë.

Data e shpalljes 15.05.2018
Data e zhvillimit 20.06.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Pembarimore L.D.C me adresë Rruga “Myslym Shyri” Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

Marrëveshja Tsipras-Zaev nuk është pëlqyer nga fqinjët jugorë: Jemi të zhgënjyer

Protesta kundër marrëveshjes së re mes Shkupit dhe Athinës

Reagim në Greqi kundër emrit "Maqedonia e Veriut"

Në Greqi, ndërsa në parlament debatohet lidhur me kërkesën e opozitës që ka paraqitur një mocion mosbesimi ndaj qeverisë për shkak të çështjes së emrit të Maqedonisë, në rrugët e Athinës kanë filluar protesta tri ditore. Marrëveshja e arritur të martën që Maqedonia të mbajë emrin Maqedonia e Veriut, po kundërshtohet si në Athinë edhe në Shkup.

Në Greqi, protestues të shumtë kishin dalë dje në rrugët e Athinës, duke kënduar himnin kombëtar dhe duke valëvitur flamuj, për të protestuar kundër marrëveshjes së arritur mes udhëheqësve grekë dhe maqedonas, për të zgjidhur çështjen e emrit të Maqedonisë. Marrëveshja Tsipras-Zaev u arrit pas debatesh disa dekadëshe dhe ajo i jep një emër të ri vendit të banuar nga maqedonas dhe shqiptarë, Maqedonia e Veriut. Protestuesit grekë, në mesin e të cilëve kishte edhe banorë të provincës greke që mban emrin Maqedoni, thanë se ndjeheshin të tradhtuar nga qeveria.

"Tsipras nuk duhet ta kishte nënshkruar marrëveshjen. Ai po na tradhton. Ndjehem tepër e zhgënjyer," thotë një protestuese.

"Unë jam maqedonase dhe nuk kam për ta pranuar kurër një emër që bart emrin Maqedonia, as e veriut, e



jugut, e lindjes, apo e perëndimit. Unë jam maqedonase dhe ata nuk janë. - thotë Athina Kechatzis, banore e provincës greke të Maqedonisë.

Kryeministri grek Alexis Tsipras dhe homologu i tij maqedonas Zoran Zaev, ranë dakord më 12 qershor për emrin, pas një mosmarrëveshje-

je 27-vjeçare. Çështja e emrit është bërë pengesë për pranimin e Maqedonisë në Bashkimin Europian dhe në NATO.

Por pas arritjes së marrëveshjes, si Zaev, edhe Tsipras, u akuzuan në vendet e tyre për "kapitullim të çështjes kombëtare".

"Kjo është një marrëveshje që nuk garanton një zgjidhje

nga e cila do të përfitonte popullit grek dhe ai i vendit fqinj, apo popujt e mbarë rajonit. Pretendimet e qeverisë së marrëveshja garanton paqen, bashkëpunimin dhe stabilitetin në Ballkan dhe më gjerë, janë gënjeshtra, ato çorrientuese dhe pa baza historike." - tha udhëheqësi i Partisë Komuniste të opozitës.

REAGIMI I MAQEDONASVE

Presidenti Gjorgje Ivanov ka thënë se nuk do ta nënshkruajë marrëveshjen. Në Shkup këto ditë ka pasur protesta të qytetarëve, të cilët nuk duan që vendi i tyre ta ndryshojë emrin.

Protestat e së premtes u zhvilluan ndërsa ligjvënësit grekë po debatoheshin në Parlament mbi një mocion mosbesimi ndaj qeverisë, të cilët kërkuan të enjten nga partia kryesore e opozitës, Demokracia e Re. Debatë në parlament pritet të përfundojë të shtunën.

Marrëveshja Tsipras - Zaev është kundërshtuar

edhe në Maqedoni nga opozita. Presidenti Gjorgje Ivanov ka thënë se nuk do ta nënshkruajë marrëveshjen. Në Shkup këto ditë ka pasur protesta të qytetarëve, të cilët nuk duan që vendi i tyre ta ndryshojë emrin.

Marrëveshja për emrin e ri të Maqedonisë është përshëndetur nga përfaqësues të komuniteti ndërkombëtar, që i kanë përgëzuar autoritetet qeveritare si në Shkup, edhe në Athinë. Ajo u mirëprit nga Departamenti Amerikan i Shtetit, BE-ja dhe NATO.

Edhe ekspertë amerikanë për Ballkanin e kanë cilësuar marrëveshjen si një zhvillim shumë pozitiv. Në një diskutim një u zhvillua këto ditë në Uashington, ajo u cilësua si një hap përpara në rrugën drejt anëtarësimit të Maqedonisë në NATO dhe në Bashkimin Europian.

Në Berlin po krijohet një rezistencë e fortë kundër Kancelares

Merkel në stuhinë e konservatorëve, sherr për politikën ndaj refugjatëve

"Ne jemi në gjendje ta bëjmë këtë". Një fjali, disa fjalë të thëna nga Kancelarja gjermane Angela Merkel kur ndodhi kriza e refugjatëve tre vjet më parë. Fjalë të kthye në moto të politikës gjermane të migracionit, por edhe në molla shërri. Kur në verë 2015, numri i refugjatëve në Europë arriti kulmin, Gjermania mori vendim të haptë dyert, ndryshe nga çfarë bënte vendet fqinje.

Me vendimin që mori Merkel mbledhi shumë kritika, edhe mes radhëve të veta. Kritiku më i madh mes tyre: Horst Seehofer, në atë kohë kryeministër i Bavarisë, ndërkohë ministër i Brendshëm në kabinetin e Merkelit.

Kryetari i konservatorëve bavarezë ishte i mendimit se Gjermania nuk është në gjendje ta përballojë këtë. Ai luftoi me të gjithë forcat kundër kursit të Merkelit. Duke qenë kryeministër i Bavarisë, ai kërcënoi në vitin 2015 se do të ngrinte padi në Gjykatën Kushtetuese kundër pranimin të refugjatëve dhe kritikoi hapur kancelaren në një kongres të partisë socialkristiane,



CSU. Për të marrë pjesë në qeverisje në nivel federal, CSU vuri si kusht kufizimin e migracionit.

SEEHOFER KËRKON TË NDRYSHOJË POLITIKËN PËR DHËNIJE AZILI

Tani duke qenë ministër i Brendshëm mund të merret me këtë detyrë, mbase më shumë se e ka për zemër. Skandal i për vendimet e manipuluar të azilit të Zyrës Federale të Migracionit dhe Refugjatëve (BAMF) pati shtruar pyetjen, nëse Gjermania nuk ka qenë vërtet e ngarkuar me shtimin e numrit të refugjatëve. Por, sipas njoftimeve të mediave numri i lartë i azileve të dhëna në zyrën e BAMF në Bremen, mund të ketë pasur edhe arsye të tjera.

Me një "Masterplan për migracionin", Seehofer kërkon të ndryshojë poli-

tikën e imigrimit dhe të marrjes së azilit në Gjermani. Ndër të tjera Seehofer kërkon që futja e azilkërkuësve të pengohet, nëse këta janë regjistruar një herë në një vend tjetër të BE-së.

Kancelarja Angela Merkel refuzon zgjidhje që të përfshijnë vetëm Gjermaninë. Ajo i qëndron besnike vendimit të Gjykatës Europiane që flet kundër kontroleve sistematike në hapësirën e Shengenit.

Nga ky kundërshtim i Merkelit për planet e Seehoferit shpërtheu grindja që vazhdon mes vitesh midis dy politikëve. Ministri i Brendshëm refuzoi të prezantonte masterplanin e tij, pastaj pak më vonë bëri të ditur se nuk do të marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë për integracionin që zhvillohet në zyrën e Kancelares.

Depozitat Fibank - interesat me konkurrese ne sistemin bankar, shumëllojshmëri dhe fleksibilitet



Depozitat Fibank janë të shumëllojshme me kombinimin e tipareve të ndryshme në mënyrë që të plotësohen sa më shumë kërkesat dhe dëshirat e klienteve. Ofrohet mundësia e Depozitave afatgjata si Depozita Dinamike 4 vjeçare, me norma interesi progresive deri në 6.5% në Lek, 2.5% në EUR/USD dhe nuk e humb interesin e viteve parardhese nëse e mbyll para se të behen 4 vite. Po ashtu ofrohet edhe "Depozita 2 Vjeçare" me interes fiks 2% në Lek & 1% në EUR.

Mund të zgjidhet edhe nje depozite fleksibel që ofron mundesine per te Shtuar dhe Terhequr kurdo që klienti dëshiron pa humbur interesat. "DEPOZITA E HAPUR" është 1 vjeçare me Interes progresiv deri në 5% në Lek & 3.5% në EUR.

Fibank ka nje Llogari Kursimi me norme interesi me te larte se i nje depozite 1 vjeçare standarte ne sistemin bankar! Ne Llogarine e Kursimit mund te menaxhohen mjaft mire kursimet ne LEK, EUR dhe USD. Kjo llogari është pa afat dhe ne te mund te depozitohet e terhiqet kurdo që klienti dëshiron, pa i humbur interesat.

Diversifikimi i depozitave ka konsideruar madje edhe dëshirën e disa klienteve që të mund ta shijojnë interesin e depozites se tyre që në ditën e pare. Nëse klienti do të donte të perdorte ne avance shumen e perfituar nga depozita per pushime apo çfaredo shpenzimi, Fibank ofron Depoziten "Rekord" në Lek, EUR dhe USD. Kjo depozite është nje kombinim i interesave te larta dhe pageses se menjhereshme te te gjithë shumës se interesit ne ditën e depozitimit.

Duke qene nje banke dinamike me vendim-marrje teper te shpejte, Fibank e ka te mundur te ofroje produkte te diversifikuara dhe fleksibel me nje sherbim cilesor te pershtatur me se miri ndaj cdo kerkese specifike te klienteve.

Skuadra Fibank është e dedikuar ne ritjen e bazes se klienteles duke i kushtuar rendesi te vecante cdo tipi klienti, duke i sherbyer klienteve te mire potenciale me cilesi dhe produkte te dizenuara me kujdes.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 614

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela ALIAJ - Art Designer: Nevila Samarzhi

E shtunë 16 Qershor 2018


TURJAN HYSKO: Dorëheqja e panegociueshme, do të nis një kapitull të ri



*Prezantuesi i njohur
Programi i ri do të ketë në fokus familjen.
Erdha që të rri gjatë. Orinda shtatzënë?
Drejtori i ri i "Klan Plus" shuan zërat për t'u bërë baba së shpejti*

ROZA LATI

"Asnjëherë nuk jeni të kënaqur me mua!", kujt i hakërrehet moderatorja?



AURELA HOXHA:

Jeta ime e re mes Spanjës dhe Shqipërisë

*'Showgirl'-i shqiptar rrëfen gfarë e largoi nga Shqipëria.
'Synimi i tregut ndërkombëtar me markën e rrobave'*

Intervista/ 'Showgirl'-i shqiptar rrëfen çfarë e largoi nga Shqipëria

Pej disa kohësh ajo i ka mundur publikut shqiptar. An gazhimi i saj tashmë synon tregun ndërkombëtar. Flasin për Aurela Hoxhën, që prej disa kohësh është angazhuar me linjën e veshjeve të banjës. Në rrëfimin e dhënë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" 'showgirl'-i shprehet se në jetën private ndjehet mirë, por edhe këtë herë nuk pranon të ndajë me publikun lidhjen e re të dashurisë.

Elsa Doda

Aurela, prej disa kohësh jeni zhvendosur në Spanjë, si po ju ecën jeta atje?

Nuk jam zhvendosur në asnjë vend për momentin, jam thjesht me projekte në Spanjë, Paris dhe Milano. Po punoj pak me markën time jashtë Shqipërisë, por akoma nuk jam zhvendosur në asnjë vend përfundimisht. Janë udhëtime pak më të gjata, por dua që marka ime të marrë rrugë jashtë vendit.

Rreth një muaj më parë realizuat në Barcelonë sfilatën për linjën e bikinive, shkoi sipas pritshmërive tuaja?

Po, ishte një organizohem i bukur, i mbështetur nga ambasada jonë në Spanjë e gjithashtu nga shumë media dhe ndërmarrje të rëndësishme këtu. Pati impakt të mirë, ka edhe shitje e kërkesa, për hir të së vërtetës jashtë pritshmërisë sime. Uroj që të jetë vetëm fillimi ky, të suprizohem për mirë në çdo hap të linjës sime.

A synoni tregun ndërkombëtar me linjën "Aurela Hoxha Swim Made in Albania"?

Tashmë është pikësynimi im dhe puna ime primare, ka pak kohë që jam tërhequr nga çdo gjë tjetër, flas këtu për projekte televizive dhe punë të tjera të mijat në Tiranë, për t'u përkushtuar vetëm kësaj.

Modele, aktore, bizneswoman, me çfarë tjetër do e surprizoni publikun?

Është mirë të kesh shumë eksperiencë, të testosh veten në shumë drejtime dhe të gjesh veten. Unë kam disa projekte, pasi pasioni im si aktore është parë që kishte të fshehur dhe talent, dhe kjo ka bërë të kem plane, oferta dhe shumë projekte të tjera, të cilat besoj do t'u përkushtohem për sa

AURELA HOXHA: jeta ime e re mes Spanjës dhe Shqipërisë

'Synimi i tregut ndërkombëtar me markën e rrobave'



kohë pasioni im për filmin, televizionin vazhdon i njëjtë.

Me çfarë projekti jeni duke punuar momentalisht, mund të na jepni disa detaje?

Momentalisht jam tërësisht e përkushtuar në linjën e veshjeve të banjës, pra markës sime, që të jetë një markë e njohur edhe në vende të rëndësishme, siç është Spanja, Franca, Italia. Kam edhe oferta për punë të tjera lidhur me modën, filmin, gjithmonë në këto vende ku po punoj, kam edhe në Shqipëri disa projekte, për të cilat është shumë herët të flas, për sa kohë jam tërësisht e fokusuar në markën time.

Në rrjete sociale ju kemi parë në studion e "Bellejour", na tregoni



pak mbi këtë?

Është një studio kreative, me të cilën po bashkëpunoj njëkohësisht në disa projekte, një prej tyre do jetë një film me metrazh të shkurtër, për të cilin jemi në fazë përgatitore. Gjithashtu, po punoj me ta për promovimin e linjës sime. Bashkëpunova për sfilatën, janë një ekip shumë i mirë dhe që për momentin kam gjetur veten. Po më ndihmojnë në disa drejtime, për të njohur tregun këtu dhe për ta eksploruar.

Çfarë po ju mungon më tepër nga Shqipëria? A është në planet e tua rikthimi?

Shqipëria është ajo që më ka bërë kjo që jam. Çdo projekt i imi ka gjithmonë parasysh tregun "tim", pra publikun shqiptar. Unë kam vetëm pak kohë që isha me një projekt mjaft të ndjekur në Shqipëri, siç është "Dance With Me"! Besoj do kemi të reja shumë shpejt...

Si po shkon jeta private?

Jeta private dhe publike në këtë rast nuk janë të ndara si me thikë, dua të them që puna ime është dhe pasioni im më i madh, kjo më bën të jem e lumtur dhe të kaloj momente të mira.

A ishte partneri, arsyeja pse u larguat nga Shqipëria?

Siç e thash pak më lartë, unë nuk jam larguar nga Shqipëria, kam projekte jashtë, siç kam pasur edhe më herët, thjesht tani është diçka më e madhe, më konkrete siç është marka ime dhe kjo po më mban pak më gjatë të larguar, por nuk jam zhvendosur në asnjë vend tjetër.

Pse nuk flisni për të dashurin apo



ta bëni publik?

Jeta ime sentimentale nuk ka pse të ketë asnjë interes për publikun, pasi ata që më duan dhe ndjekin mua, janë ata që kanë pëlqyer apo dashur çdo gjë që unë kam bërë prej vitesh në modë apo televizion dhe shumë projekte të tjera, por asnjë herë për ndonjë gjë tjetër lidhur me jetën time sentimentale, nuk është ajo që do bej sensacion te publiku, s'do jetë kurrë. Ajo është pjesë shumë intime e imja dhe nuk dëshiroj ta ndaj me asnjë.

Sa e dashuruar ndjeheni?

Ndjehem shumë mirë!

A keni plane për martesë? Po për fëmijë?

Nuk janë plane, as mendime të cilat do t'i ndaja me publikun në asnjë rast. Këto janë gjëra kaq intime, sa vetëm të tilla kanë kuptim dhe "shije".

Para disa kohësh treguat se jeni bërë vegjetariane, çfarë ju shtyu drejt kësaj?

Dashuria ime e madhe për kafshët është gjithashtu një jetë shumë e shëndetshme dhe e mirë. Ka shumë ushqime të cilat e zëvendësojnë mishin dhe nëse do mundja, do të bëja gjithçka që të gjithë njerëzit të ndjekin rrugën time. Është kaq bukur t'i duash dhe t'i mbrosh kafshët, ato janë qenia më e pastër në planet. Do doja siç thash më lartë të kisha mundësi të bëja gjithçka për to.

Dini gjithmonë si të tërhiqni vëmendje me 'look'-un tuaj, ku frymëzoheni?

Nuk kam një pikë frymëzimi, edhe pse influencohem nga trendet dhe moda e fundit, çdo tendencë ndjek dhe sigurisht e bëj pjesë të 'look'-ut tim, por gjithmonë ka pak Aurel në gjithçka timen, siç mendoj që është e drejtë të jetë, që të gjithë të ndjekim modën, duke lënë aty brenda pak nga vetja.

Përveç plazhit dhe rrezeve të diellit, çfarë bëni në kohën e lirë dhe me kë e kaloni më së shumti?

Më pëlqen të lexoj, të vrapoj, të njoh vende dhe kultura të reja, është bukur të kesh kohë për të njohur gjithçka.



Prezantuesi i njohur: Programi i ri do të ketë në fokus familjen. Erdha që të rri gjatë

Largohet nga "Vizioni" për në "Klan", TURJAN HYSKO: Dorëheqja e panegociueshme, do nis një kapitull të ri



Orinda shtatzënë? Drejtori i ri i "Klan Plus" shuan zërat për t'u bërë baba së shpejti

Pamela Aliaj

Pas një periudhe të gjatë kohore që keni punuar në "Vizion Plus", vendosët të nisni një kapitull të ri në TV "Klan". Pse vendoset të largoheshit?

Besoj që pas kaq shumë vitesh kërkoja sfida të reja, energji tjetër, dua stimuj të cilët besoj i gjej në "Klan".

Gjithashtu me largimin tuaj do të merrni me vete edhe grupin e "2XL" për t'u zhvendosur si emision në "Klan". Ishte propozim i juaji që në fillim apo...?

Stafi i "2XL" është pothuaj familje për mua. Sigurisht që vendimi për t'u larguar nuk mund të linte jashtë planit një 'show' që e kemi ngritur me shumë mund dhe dashuri, kështu që i gjithë stafi m'u bashkua në "Klan".

Së shpejti do të jeni drejtor i përgjithshëm në "Klan Plus", a do ta risillni serish "Oktapod" në televizionin e ri?

Jo! Nuk ka vend në "Klan" për "Oktapod"!

A do t'ju bashkohet edhe bashkëshortja, Orinda, në rrugëtimin e nisur?

Jo, jo!

Në intervistën e mëparshme thatë se "Klan



Plus" do të ndryshojë emër dhe do të jetë zgjatim i TV "Klan" si televizion gjeneralist. Çfarë vizioni keni parasysh të sillni në këtë televizion dhe çdo të ketë ndryshe nga TV-të e tjera?

Për momentin nuk mund të jap detaje, pasi jemi duke punuar mbi skemën programore!

Thatë që "2XL" do të ketë ndryshime i sjellë në "Klan" si dhe përveç tij, do të sillni edhe një projekt të ri. Për çfarë ndryshimesh bëhet fjalë për "2XL"? A do të ketë ndry-

shim personazhesh apo formati?

Mund të them vetëm që gjithçka do bëhet më e madhe dhe do ketë shumë surpriza!

Çfarë mund të na thonit lidhur me projektin e ri që do të sillni në "Klan"?


Do jetë një program, i cili do ketë në fokus familjen! Do luajmë, do emocionohemi dhe sigurisht do fitohet shumë.

Si e pritën Dulakët largimin tuaj? A pati propozime joshëse për të qëndruar?

Dorëheqja ishte e pane-

Pas thashethemeve të shumta për largimin e tij nga "Vizion Plus" për të nisur një aventurë të re në një tjetër televizion gjeneralist, Turjan Hysko rrëfëhet në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" për të gjitha projektet e reja që pret të nisë në shtator në "Klan". Ai gjithashtu ka shuar edhe zërat për një shtatzëni të mundshme të bashkëshortes së tij, Orindës. Programi i ri në "Klan", ndryshimet e "2XL" dhe shumë detaje të tjera të pathëna i zbuloni në intervistën e mëposhtme.





Turjan Hyska

2 mins · 

Pas 14 viteve dhe më shumë se 13 programe të realizuara, sezoni i ri televiziv nuk do të më gjejë më në Vizion Plus! Një vendim i vështirë, por i pakthyeshem, i ardhur natyrshëm pas një eksperience që mund ta quaj fantastike në tërësinë e saj! Në Shqipëri thonë që është pothuajse e pamundur të shkëputesh pa mëri apo inate! Epo ky është një ndër ato rastet që ndodh!

Së pari, dua të falenderoj Genc Dulakun, i cili më dha mundësinë të provoj çdo rol në atë kompani, nga drejtues programesh me fëmijë deri tek të qënurit drejtor ekzekutiv në Vizion Plus.

Une u rrita ne familjen "Vizion Plus" duke punuar, duke gabuar, mësuar, dështuar apo duke shijuar suksese! Duke marrë vet vendime të drejta apo të gabuara. Dhe kjo ishte fantastike!

Termi "familje" shpesh duket klishe, por nuk gjej fjalë tjetër për grupin e Vizionit, pasi të qënurit familje ka qënë forca më e madhe e atij institucioni dhe uroj me shpirt mos ta humbasë kurrë këtë tipar dallues!

Dua të falenderoj pa përjashtim të gjithë njerëzit (edhe ata që s'më duan hiç) me të cilët u rrita në atë kompani, sepse të gjithë kanë punuar dhe ndihmuar për të ndërtuar "Turin e Vizionit". Kam marrë shumë nga të gjithë dhe uroj që t'i kem dhënë po aq shumë!



njësoj, të lumtur!

U përfol kohët e fundit për një shtatzëni të Orindës. Do të bëheni baba së shpejti? Jo!

Turjan Hyska, këngëtar, moderator, ideator, producent, editor dhe autor. Si e identifikoni veten dhe cila është sfida e radhës?

Sfida e radhës është ajo për të cilën realizuam këtë intervistë.

Kur dhe si e mendon veten të plotësuar Turi? Cila është maja e arritjes për ju?

Maja më e lartë për mua është të qëndruarit me këmbët ngulur fort në tokë.

Ndërkohë që jo më larg se dje ka reaguar nëpërmjet një statusi në "Instagram" edhe Julian

Deda, duke i falënderuar me zemër pronarët e "Vizion Plus" për lirinë dhe rehatinë që i falën për nëntë vjet në "2XL". "Po largohemi pa hatërmbejtje", shkruan ndër të tjera Juli. Një bashkëpunim vërtet i frytshëm dhe jo vetëm në këtë produksion, por edhe në të tjerë që aktori ka marrë pjesë. Ndërkohë që e mbyll statusin duke shkruar: "Do të nisim një rrugëtim të ri, na shkoftë mbarë!".

gocueshme, kështu që s'kishte vend për oferta joshëse. Unë kam qënë shumë i lumtur në "Vizion Plus" dhe "Tring" si profesionalisht dhe financiarisht.

Si erdhi propozimi për t'u bërë pjesë e "Klan" nga Frangaj? Çfarë ju bindi më tepër të vendosnit?

Erdhi nga një kafe e thjeshtë! Ishte marrë vesh që unë doja të largohesha dhe pas takimit të parë, Aleksandër Frangaj tha: "Ti do jesh pjesë e 'Klanit' tashmë", të tjerat janë detaje. Dhe unë kam ardhur në "Klan" për të qëndruar gjatë.

Për pak dhe mbushet një vit që jeni martuar me bukurshen Huta. Si është bashkëjetesa me të? Çfarë ka ndryshuar në një vit nga momenti që jeni shpallur burrë e grua?

Asgjë! Vazhdojmë po





Det, diell dhe shumë ëmbëlsi, Bieta poston foton që do ju mbushë zemrat

Pavarësisht kohës, vera nuk na lë që të qëndrojmë për shumë kohë larg detit dhe shpesh herë nuk i rezistojmë dhe shkojmë e shijojmë ato pak orë me diell. Këtë gjë ka preferuar të bëjë edhe Bieta Sulo së bashku me vogëlushin e saj Kroiarit. Ajo ka postuar së fundmi një foto të ëmbël ku mban vogëlushin për dore dhe janë shtrirë të dy në rërë duke shijuar perëndimin e diellit dhe aromën e detit. Diell, det dhe shumë dashuri! Ku ka më bukur!




Bëmë baba të të ngjaj... apo e kundërta? Vesa Luma na vë në dilemë

Edhe pse është larg ajo nuk harron të na mbajë në korrent lidhur me jetën e saj të re në Zelandën e Re. Vesa Luma na kënaq me statuset e saj të vogëlushit Liam dhe të bëmave të tij. Kësaj radhe nuk është një, por dy! Lu bashkua edhe Big Basta në bëmat e përditshme. Bëmë baba të të ngjaj apo përshtatju djallit? Të dy të ulur në dyshe me shohin një film për fëmijë të quajtur "Minions". S'ka momente më të bukura sesa të shijosh kohën me vogëlushët. Fëmija të bën sërish të vogël, apo jo?



Minions ON



Turqia, destinacioni i preferuar! Rudina Dembacaj nis pushimet në hotelin luksoz


Pas angazhimeve të një sezoni të ngjeshur, më në fund pak pushim për aktoren e njohur, Rudina Dembacaj. Mesa duket shumë prej VIP-ave e preferojnë Turqinë si destinacion të tyre

të parë në këtë sezon veror. E pse të jetë ndryshe? Gjithë shërbimet dhe ambientet e ofruara të bëjnë të mos t'i rezistosh një udhëtimi për në hotelet turistike. Edhe Rudina ka vendosur që

këto pushime t'i çelë në Turqi nën rrezet e një dielli dhe në shoqërinë e familjes, pushimet e këtij viti do të jenë fantastike për aktoren Dembacaj!

“Asnjëherë s’jeni të kënaqur me mua!”, kujt i hakërrehet Roza Lati?

Nuk është hera e parë që Roza Lati i kërkojnë që të ndërhyjë në çështje që lidhen me kafshët. Duke ditur se sa e lidhur është ajo me qentë sidomos, ndjekësit e saj i kanë kërkuar ndihmë për një qen që po keqtrajtohej. Por mesa duket moderatores së “Why Not” i ka ardhur në majë të hundës me njerëz mosmirënjohës për veprimet dhe reagimet e saj lidhur me këto kafshë të pambrojtura. Kështu që ajo, nëpërmjet një statusi në ‘Instastory’, u tha që të veprojnë vetë në vend që t’i kërkojnë ndihmë asaj, duke qenë se nuk kënaqen asnjëherë me veprimet e saj. Por kjo s’do të thotë që Roza do të heqë dorë nga mbrojtja e tyre, pavarësisht kërkesave të pafund të ndjekësve. “Ndhimjini vetë”, thotë Lati. E pse jo, të gjithë të veprojnë që mos të ketë më sjellje të tilla barbare tek kafshët e pambrojtura!



Një tjetër këngë erotike? Enca “vë tellallin” për një model seksi

Mesa duket nuk ka ndërmend të ndalet! Enca Haxhia, pas suksesit dhe zhurmës që i dha videoklipi i këngës “Dua”, kërkon të sjellë në jetë një tjetër! Nëpërmjet një statusi në ‘Instastory’ ajo kërkon modelë të rinj dhe seksi. Duket se bukuroshja që parapëlqen të bëjë gjithnjë zhurmë nëpërmjet postimeve apo fotove provokuese të sjellë në jetë një tjetër projekt po aq “hot” sa edhe ai i mëparshmi. Kushedi se ç’ka në mend këtë radhë këngëtarja, por me siguri që do të ketë reagimet e ndryshme të ndjekësve të saj.



“Përjetësia ime”, Afërdita emocionon me fjalët për të fejuarin

E dhe pak ditë i ndajnë nga dita e madhe. Ndërkohë që nuk kanë se si të mungojnë dedikimet dhe statuset e shumta. Afërdita, pas udhëtimit të festës së beqarisë që bëri në Las Vegas, është sërish nën shoqërinë e të fejuarit duke shijuar së bashku çdo moment para ditës së madhe. Kjo duket edhe në statuset e këngëtares nga Kosova, e cila duket më e dashuruar se kurrë. “Përjetësia ime”, shkruan Afërdita, ndërsa poston një fotot ku të dy kanë shtrënguar duart. Mezi presim ta shohim nuse bukuroshen, e cila në 29 qershor do të bëjë ceremoninë e celebrimit në Miami me shumë të ftuar VIP nga Shqipëria.



PROTESTA

Artistët ruajnë teatrën me turne, Anagnosti: Mëkat të shembet

“Revolucioni nis në shi”, Ben Derhemi e Alfred Trebicka ironizojnë Laert Vasilin që mbështeti shembjen

Alfred Trebicka: Do vdesim të qetë se nuk jemi këllira, pastruam radhët tona

Bujar Asqeriu: Më prenë fjalën në dëgjesë, Altin Basha: Nuk është kapanon

Fatmira Nikolli

“Revolucioni” nisi me shi. Dhjetëra qytetarë iu bashkuan dhe protestës së artistëve për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, godinës dhe truallit pas kërkesës, projektit dhe projektligjit për ndërtimin e një teatri të ri përmes partneritetit publik-privat. Artistët e quajtën të dështuar dëgjesën me kreun e bashkisë Erion Veliaj. Ata thanë që prej ditës së djeshme nis ruajtja me turne. Dje protestës iu bashkua edhe Roza Anagnosti e Sesilia Plasari.



MEHDI MALKA

Kur po vija këtu tani në Myslëm Shyri pashë një nënë që mbante një fëmijë 4 vjeç të që thoshte “mos e prishni teatrin”. Ajo nëna tha “s’e dëgjon njeri ashtu si ju”. Do na dëgjojnë.

ROZA ANAGNOSTI

Kam ardhur sot këtu për të mbështetur artistët dhe se këtu është jeta jonë. Të them të prishet do ishte mëkat i madh. Më kanë shtyrë të vij figurat e grave që kanë themeluar e kanë sakrifikuar për këtë teatër si Behije Çela, Liza Vorfi, Drita Pelinku, Violeta Manushi. Instrumenti jonë jemi vetë ne.



SESILIA PLASARI

Të gjitha janë thënë. Edhe njerëzit që flasin përsërisin. E vërteta dihet. Ajo që më bën të vuaj është se ata që mblidhen këtu janë ata që s’kanë asnjë interes, njerëz që i kanë fituar ato që mund të fitonin. Jam këtu për hir të qytetarisë kundër barbarisë. Si ka mundësi që më të mirët janë të sakrifikuar. Sa kohë do vazhdojë sakrificat e më të mirëve. Duhet të shpikim një mënyrë tjetër proteste. Jo me grevë urie se jeta është e shenjtë. Duhet të kërcejnë mbi portretin e diktatorit, të qëllohet mbi fytyrën e diktaturës.



ALERT ÇELOALIAJ

Është tubim jopolitik, sepse është thënë se ndikohet nga partitë. Nuk ka përkatësi politike edhe pse kemi trokitur në zyra. Kemi vajtur për të kërkuar e për të shpallur mos cenimin e tokës dhe godinës së Teatrit Kombëtar dhe atij Eksperimental. Vlera më e madhe është simbolika. Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit dhe Mësonjëtorja e Korçës s’kanë vlerë ai arkitekturë, por si simbolika. Këtu janë ngritur institucionet kryesore të vendit. Kemi frikë të kërkojmë 10 teatro të reja se çfarë duhet të japim për t’i pasur. Është bërë e qartë se nuk bëhet asgjë pa PPP.



ALFRED TREBICKA

Se vija në dyshim që do kishte njerëz. Takimi me kryebashkiakun bëri mirë se kuptuam shumë. Pastruam radhët tona. Të mendimet tona bëhet diferenca kush është këllirë. Duhet të kesh nivel të lartë që të jesh ekspert me këllirë. Nga një qëndrim i joni se ne s’kemi nisur ende të veprojmë- janë të qarta të gjitha. Falë atij takimi dje ne jemi sot këtu. Ishte e qartë se çfarë qëndrimi ka Ndrenika e Arbana e çfarë kanë brezi i të paaftëve. (Ironizon Laert Vasilin- më falni që fola greqisht). Jemi të sigurt se brezi është. Ne si komitet artistësh pa popullin jemi të humbur. Ne me këtë qëndrim që mbajmë sot do vdesim të qetë se s’do na thonë jemi këllira. Ata të sofistikuarit le të shkojnë të hanë makarona poshtë urave në Francë.




BUJAR ASQERIU

Teatri është i qytetarëve të Tiranës. E vlerësova bisedën e së enjtes. Sa dola unë u pre sinjali. Luftova korrupsionin deri në zemër dhe kjo është filozofia ime. Kryeministri tha tolerancë zero ndaj hajdutëve, këtë thashë dhe unë, por u censurova. Të rrisim kurajon qytetare. Thashë të ruajmë trashëgiminë e mu pre fjala. Nuk e di ku kam gabuar. I dërgoj një të puthur kreut të bashkisë. Të shohim kampionatin pas 4 vitesh se këtë kampionat s’do më ftojë se është i zemëruar.



EDVIN KULLURI

Kjo qeveri ka lekë për stadiumin e Shkodrës e të Elbasanit se atje nuk shiteit kulla. Kjo është çështje interesi privat jo publik. Nuk i kemi borxh askujt ndërtime me kulla. Është çështja jonë se ne vijmë ta shohim.



ROBERT BUDINA

Kreu i bashkisë në dëgjesë s’kishte vend se s’ka ligj ende. Do mblidhemi çdo ditë këtu për aktivitete kulturore e për biseda për teatrin. Do e ruajmë teatrin ditë e natë dhe do mblidhemi këtu çdo ditë në orën 19:00. Nuk tërhiqemi se sa të jemi bashkë, fitojmë.



BEN DERHEMI

(ironizon Laert Vasilin) “Kam ardhur nga teatrot europianë. Këtu qenka katrahurë”. Duhet t’i abandojmë ata që na përdorin dhe që na marrin nëpër këmbë. Fusha e shtyn nga pas Ramën se janë miliona në mes. Kjo tokë ka zot, ky teatër ka zot.



ALTIN BASHA

Më lind pyetja pse dalin në oborrin e teatrit kur kryeministri është artist? Duhet të ishim komuniteti më i favorizuar, jemi më të marginalizuarit. Se ne nuk prodhojmë vota. Ndërtesa përballë është rikonstruktuar. Pse kjo jo? Qeveria ka rikonstruktuar çdo godinë ministrie. Le të shesë një aset. U kërkuan të tërheqin projektligjin, por nuk e bënë. Të djathtës po i intereson kjo situatë, ju bën fresk. Të majtët po presin të shkojë ligji ta votojnë. Kur në bashki ishte një i djathtë desh bën xhaminë me kulla. Le të dalin të majtët të sillen si qytetarë. S’mund ta bëjmë teatrin si La Fenice, po askush të mos e shohë si kapanon.



RUDIN SATA

Bëhet fjalë për 500 milionë euro (kaq kushton trualli) dhe për 4500 metra katrorë.



Opinion i Ditës

Si mund të lexohet kjo G7?

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faja 1)

... e marrëdhënieve ndërkombe...

Ai nuk ka lindur rastësisht, por ka qenë produkt i filozofisë së punës...

Harmonizimi i këtyre përbërësve i kontribuoi forçimit të kohezionit të brendshëm...

Pavarësisht se ka ndryshuar mendësia e njohtës së përmbajtjes së informacionit për këto veprimtari...



së informacionit, por sidomos për një demokratizim të ndjeshëm...

Pikërisht dhe ky samit i G7 u thirr në një moment të rëndësishëm...

funksionimit të këtij formati dhe rolit e mundësive që ka për të kontribuar në zhvillimet e qëndrueshme ekonomike...

Cdo herë ka pasur diskutime e debate të gjalla brenda perëndimit...

Pas kësaj vjen vetiu pyetja: sukses apo dështim ishte ky samit?

apo që në fund u dakordësuam me disa hapa e qëndrime konkrete, por që mban në konsideratë dhe tërheqjen e nënshkrimit nga teksti i deklarates...

Ka një mendim se ky qëndrim i presidentit Trump mund të interpretohet si një formë aplikimi e konkretizimi i tezës "America first"...

Askush nuk mund të parashikojë saktë se si do të evoluojë kjo kontradiktë e grindje brenda tyre...

shijë m i marrëdhënieve brenda Perëndimit mund të thellohet me tej, të zgjerohet përmbajtjen. Me sa duket ka ardhur koha e një ndalesë konkrete që të fokusojë diskutimin e atyre problemeve që ndajën në aleancë.

Këto zhvillime brenda Perëndimit nuk mund të mos tërheqjen vëmendjen e Rusisë dhe Kinës, të cilat, jo rastësisht organizuan në një kohë edhe atë takimin e organizimit ekonomik të bashkëpunimit euro-aziatik SCO...

Perëndimi e akuzoi Rusinë kësh-tu, për shkelje të rëndit të ligjit e të drejtës ndërkombe...

Në përgjigje të pyetjes dhe kërkesës së presidentit Trump, Kancelarja Merkel shfaq konsequencën perëndimore ndaj këtij gjykimi e qëndrimit, tekta argumenton se një gjë e tillë nuk do të ndodhë...

Sic shihet nga këto zhvillime, mendimi apo deklarimi i tipit se formati G7 duhet futur në muze, duket mjaft i nxituar e jo realist...

Opinion i Ditës

Gjëegjëza me Shqipërinë dhe kënaqësia për mos hapjen e negociatave!

Nga Ben Andoni

(villon nga faqja 1)

... pak e nga pak. Zoti kish vendosur të shihte se ç'bënin krijesat e tij në Tokë. Kishte mbetur i mërzitur me Parisin e francezët me ndryshimet dhe bëmat e tyre moderne, ca më keq me italianët e Romën, po kaq me Londrën e Berlinin, sepse vendet ishin modernizuar frikshëm. Po ku vallë u ndje i kënaqur? I huaji i sapoardhur që mezi e kuptonte fillimisht kolegun do qëndronte. E sakaq, pas ndonjë gjerbe të ndonjë porcioni të mirë alkooli të asaj kohe, vijonte përgjigja-në Shqipëri! Zoti në Shqipëri ishte kënaqur, sepse këtu gjërat nuk kishin ndryshuar, ishte fabula.

Në vitet '90 fabula u shndërrua në një gjë gati banale. Por edhe kjo qarkullonte në komunitetin e ndërkombëtarëve në vend. Mizanskena dhe butaforia: Një shportë me karavidhe, e lënë në breg prej dy peshkatarëve. Vjen batica dhe mos na ikin, thotë njëri syresh, teksa po rehatoheshin në klub. "Jo, ia pret tjetri, janë karavidhe shqiptare sapa ngjitet njëri për të ikur e kap tjetri dhe e zbrat poshtë".

Nuk dimë fabulat e reja të kësaj kohe për shqiptarët, por padyshim duhet të jenë shumë. Dhe, të huajt jo të pakët në Shqipëri që mbushin raporte, mu nga ato që e lënë vendin pas dyerve të Europës prej vitesh të tëra, duhet të kenë sajuar të tjera edhe më fine. Askujt nuk i bën përshtypje se shqiptarët mezi presin të davarisin këtë humbje shprehe që buron prej ngado. Kjo bëhet edhe shumë më e vështirë në këtë moment pasigurie dhe heshtje, paqsa se tashmë duhet të jetë vendosur fati i Shqipërisë në takimin e 28 qershorit për hapjen e negociatave. Veçse më e paqartë është kënaqësia, e cila mbartet te një pjesë e madhe e komunitetit shqiptar dhe sidomos e politikës që Shqipërisë të mos i hapen këto negociata. Opozita mëton se faji është i Ramës dhe i qeverisjes së tij dhe këtu me gjasë ka njerëz të kënaqur dhe nga e Majta e mbyllet diskursi, që nuk shtron problem-inin tjetër: Nëse vendet e Ballkanit Perëndimor nuk nisin procesin e integritimit në BE atëherë do të përballen me pasojat e dhimbshme. E para, sa i përket shpresës. E dyta mosmbajtjes së premtimit, që vetë strukturat e BE-së, kanë bërë dhe që qeveritë ballkanase i kanë realizuar.

Shumëkush e di sesi do të jetë procedura lidhur me negociatat për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ato kanë shumë shpresë, por jo me pak gjasë, do mund të jenë të kush-tëzuara. Të dy vendet realisht kanë bërë hapa përpara, Shqipëria me reformën në drejtësi, që megjithëse konsiderohet ende me shumë probleme po jep rezultate; Maqedonia



me zgjidhjen e emrit dhe lehtësimin e problematikave të pafundme në vend. Që do të thotë pjesa e tyre është kryer. Sa për të kënaqurit që Franca, Holanda dhe Gjermania janë kundër, një gjë dihet me saktësi: edhe pas disa dekadash, kur Shqipëria të jetë në BE do jenë skeptike me të. Stereotipitë e ndërtuara me shekuj nuk mund të zhbëhen në pak vite. Duket se presioni në vetë Këshilli Evropian është i madh që të mos e justifikojë raportin e

Komisionit Evropian për prioritetet kyçe, por mbase të pritë raportin i ardhshëm në pranverën e vitit 2019 për të parë ndryshime, fakt që do të thotë kthim pas. Dhe, një Evropë me probleme shtesë, nuk do mund të ndihet aq rehat. Edhe për faktin se më 2019 strukturat e BE-së do jenë krejt të tjera. Në fakt, Shqipëria e ka të vështirë të bëjë standarde, që mëtojnë opozitë tona, kur zbrësin nga pushteti dhe kjo vjen nga metamorfoza e shqiptarit të pas viteve '90 dhe vetë demokracisë së krijuar prej tij. Në këtë vazhde, Evropa me struc-

turat e saj ka për detyrë të mbajë fjalën, atë që në Ballkan e konfu- zojnë sipas mendimeve të tyre.

.

Republika e Shqipërisë është nominuar si kandidat zyrtar për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) prej qershorit 2014. Larg kësaj, një nga momentet më të mëdha të Shqipërisë ka qenë hyrja në NATO si anëtarë e plotë në 2009. Shqipëria aplikoi për anëtarësim edhe në vitin 2009. Dhe, ashtu si tani Këshilli Evropian i kërkoi Komisionit Evropian raportin për modalitetin e pranimit, e cila iu përcoll qeverisë shqiptare. Shqipëria u kthye përgjigje atyre më 14 prill 2010. Më 5 dhjetor 2013, një takim i eurodeputetëve i rekomandoi Këshillit t'ia japë Shqipërisë statusin e kandidatit. Dhe, për fat, më 23 qershor 2014, nën presidencën greke të BE-së, Këshilli i Bashimit Evropian ra dakord t'ia japë statusin e kandidatit të Shqipërisë, procedurë që i miratua disa ditë më vonë nga Këshilli Evro-

pian. Gati, njësoj është udha tani, kur Komisioni Evropian në Prill 2018 i rekomandoi Këshillit Evropian të hapë negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Është momenti politik i qershorit, kur Këshilli i Ministrave të Këshillit Evropian do të mblidhet për të diskutuar për negociatat të hapura ose jo për 2 vendet tona: Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Sido që të ndodhë, Shqipëria dhe Maqedonia e kanë kapur një cak, që duhet vlerësuar dhe po shkon falë shqiptarëve dhe maqedonasve dhe përpjekjeve të gjitha strukturave të vendeve të tyre. Për këtë duhet gjëegjëza e re. Me gjasë ajo do të dalë më 29 qershor, kur të merret vendimi. A do t'i hapen dot Shqipërisë negociatat?! Për këtë nuk ka ende gjëegjëza sepse edhe vetë të huajt e kanë mbyllur gojën në kalkulimet e fundit. Të kënaqur jemi vetë ne, shumë nga ne... që të mos na hapen negociatat, sepse jemi më mirë në vuajtje.

(Gazeta Shqiptare-Homo albanicus)

HOROSKOPI

DASHI
Nëse me partnerin është krijuar pak tension, mos e vononi çështjen për ta sganuar. Për të kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë se sa mendonit. Përfundimi nga mbështetja që ju garanton familja, për të përmbyshur zgjedhjet që do të bëni.

DEMI
Nën tërheqjen e Venusit dhe Marsit, Hëna iu pritsh disa qështje dhe krijon pengesa në rrugën tuaj të gjatë. Do të merrni të promovoni një projekt të punës, tek i cili keni shumë pritshmëri. Gjasat janë që të dalë me sukses.

BINJAKET
Për shkak të veprimtimit të Hënës, dita do të jetë disi e vështirë, me shumë keqkuptime, ankesa dhe mendime jo shumë optimiste. Sot në dashuri do të jeni pak jashtë ritmi. Asgjë për t'u shqetësuar, por dëshira për t'u larguar nuk e favorizon mirëkuptimin.

GAFORJA
Rruga e gabuar dhe vonesat mund të bëjnë që të dështojë një plan. Por mos u dekurajoni, pasi keni mundësi të gjeni zgjidhje më të mira akoma! Organizoni një udhëtim, sepse do të bëjë që të krijoni kontakte interesante me persona të panjohur.

LUANI
Nëse ndiheni të kushhtëzuar nga kërkesat dhe gjykimet e një familjari, vëriti vetes objektivat që të lironi për të marrë vendime. Duke qenë se ju pëlqen të jeni në qendër të vëmendjes, do të zbuloni se kështu do të ndiheni mirë.

VIRGJERESHA
Perfeksionizmi ju qëlon në vena, por do të ishte më mirë të lironesh nga kjo, pasi ju streson dhe çon në ndikime negative në raportet profesionale. Takimi me dikë që nuk e keni parë prej shumë kohësh do të bëjë që të ndizet një flakë e vjetër pasioni.

PESHORJA
Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Mërkuri angazhohet duke ju vënë shkopinj në rrotta. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rri për krahu dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

AKREPI
Mbështetja e Mërkurit, por me armiqërinë e Venusit dhe Marsit, do të bëjë që të ndiheni fajtor në frontin e dashurisë. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë. Nuk mund t'ia lëni më rastësisë.


SHIGJETARI
Të jeni më të dashur nuk i bën veçse mirë. Padyshim do të lehtësoni ndjeshëm raportet me personin që keni në krahu. Mos e harroni, ndërhyrja e një familjari në punët tuaja do t'ju nervozojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

BRICJAPI
Për shkak të Venusit, çështje të zemrës mund t'ju bëjnë që të lini pas dore punën. Por Saturni iu tërheq vëmendjen dhe ju shtyn të keni përqendrim dhe qartësi në mendime. Nëse e kuptoni që personat që rrinë rrethë rrotull jush nuk ju përshtrënojnë largohuni prej tyre.

UJORI
Loja e dashurisë do t'ju shtyjë të gënjejnë disi, duke shpikur ëndrra dhe iluzione, por do t'ju shërbejë për të pasur një takim edhe më të mirë. Nganjëherë përpikuni të jeni më të qirët kur nuk i kuptoni gjërat nga këndvështrimi i dikujt tjetër.

PESHQIT
Me Jupiterin që ju mbështet, nëse keni ndonjë ide të bukur që ju shkon ndërmend, vëriti në veprim. Do t'ia dini të gjeni edhe aleatë. Nëse do të ketë fërkime brenda familjes, largojuni duke e kaluar me sportivitet.

Fjalëkryqi (1)



35. Një mund të jetë fetar.
37. Lidhen të parat.
38. Fundi i një faze.
39. Emri i Bismarck.
40. Kant e Diabolik.
42. Ze... në traget.
44. Entë Informacioni Rajonale.
45. Tiolet e Trëndafilit me kredi.
47. Rruga e Ferenc Molnar.
48. Në krye të notarëve.
50. Gjysmë tati.
51. Ushtrihet me cd false.
- VERTIKAL.**
1. Numër i shkurtër.
2. Britame Arkmedit.
3. Inicialet e Paganini-t.
4. Fundi i Turandot.
5. Eshhtë fjetore ushtarësh
6. Parker regjisor.
7. Kështu quhet që ushqim kundër intoksikimit.
8. Një birrë e jona.
9. Mund të jenë përrurimi.
10. Festat pa fat
11. Qendër ditore
13. Janë nomadë.
15. Fillojnë atletikën.
16. Eshhtë brinjë në skuadër.
17. Sidney i Serpico.
18. Qe centauri që mësonte Akillin.
20. Në mes të një kanali.
25. Bëhet për zakon.
26. Tregon martesë.
27. Një super... për shopping.
33. Vala e stadiumit.
34. Fillojnë poshtë.
36. Një provë... inteligjence.
38. Vaçë e famshme e këngës tonë.
41. Fillojnë vallen.
42. Para se Salaam.
43. Linearë pa larë.
46. Nota e diapozonit.
47. Mbyllin një shtëpi.
49. I keni në dorë.

HORIZONTAL

- Mund të jetë e pasur me minerale.
- Ascoli në tabela.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.
- Janë felinë të egër.
- Marubi i fotografisë.
- Janë meduza.
- Një anarkist i famshëm.
- Smith filozof.
- Susanna shkrittare italiane.
- Shkurt për company.
- Organizma Autonome Kombëtare.
- Mbarojnë punime.
- Ndezur në aparatë.
- Bëjnë arte me re.
- Nduket për gjysmë.
- Mbyllin fushat.
- Luca bomber.
- Emri i parë i Pasolini-t.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Eshhtë skuadra e donatorëve
- Mbyllin një turp.
- Mund të jetë unik
- Një i absurdit është i Samuel Beckett
- Qyteti i përjetshëm.
- Interpreton Sandokan.
- I ka tek tenda.
- Eshhtë këngëtar lirik
- Arturo i Brecht.
- John, i forti i Sylvester Stallone-s.
- Françesku kantautor.
- Eshhtë religjion politeist.
- Qerre pa qe.
- Gjysmë alarmi.
- Eshhtë shtypi i ZP.

VERTIKAL


- Kush ka... ka zët.
- Altini mesfushor.
- Janë vajzat në atletikë.
- Eshhtë shpend lagune.
- Gjysmë thyese.
- Udhëhoqi Argonautët.
- Mund të jenë fotografikë të tillë.
- Fillojnë panikun.
- Janë çnjerëzore.
- Mund të jetë e hollë dhe therësë.
- Edi në krye të PS.
- Eshhtë loj papagalii.
- Fund tunri.
- Eshhtë dëshmore... çuditërisë.
- Para devils për lojtarët e Manchester United.
- U shkrua nga Kadare
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Pak titanike.
- Arbeni pa çifte.
- I ka tek treni.
- Mund të jenë pushimi
- Mund të prishej nga jë... kleçkë.
- Në krye të bashkisë.
- Eshhtë kundërshtar në dashuri
- Meta në krye të LSI.
- I vidhet ustait.
- Jeppet e Artë në Cannes.
- Eshhtë pije e jona.
- Kufizojnë kënde.
- Fillojnë lehtë.
- Eshhtë dritëshkurtri.
- Eshhtë numri i... të parit.
- Fillojnë nazet.



Gjeni ndryshimin




Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR



FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

		1				8		4
		9	7	2	6			3
		5				1		7
7						9		1
						5	2	
2		5		3				6
			4		8			7
		9				3		
		8			6			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	3	5	9	1	2	4	7	6
4	2	6	5	7	3	1	8	9
9	1	7	6	4	8	2	3	5
3	9	2	4	5	6	8	1	7
5	4	1	7	8	9	3	6	2
6	7	8	2	3	1	9	5	4
1	6	4	8	9	7	5	2	3
2	5	3	1	6	4	7	9	8
7	8	9	3	2	5	6	4	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Nëse nuk bëjmë të pamundurën, do të përballemi me të paimagjineshmën.

- Ende duhet të qani shumë, derisa të mësoni njerëzit të qeshin.


- Kushdo që shpëton një njeri nga një lot, ngre një metër lartësinë e njerëzimit.

- "Zgjidh njeriun që të çon të njohësh prindërit e tij, dhe jo krevatin e tij"

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mërcura

- Në thelb, kam nevojë vetëm një gotë pije për tu dehur. Problemi është se unë nuk e mbaj mend, nëse kjo është e trembëdhjeta apo e katërmbëdhjeta.
- Një fëmijë mund t'i mësojë një të rrituri, tri gjëra: të jetë i lumtur pa ndonjë arsye të veçantë, të jetë gjithmonë i zënë me diçka, dhe të di të kërkojë me gjithë forcën atë që dëshiron.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

